

BANKA PËR BIZNES SH.A.

PASQYRAT FINANCIARE TË PËRGATITURA NË PËRPTHJE ME
STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2017
ME RAPORTIN E AUDITORIT TË PAVARUR

Përmbajtja

Raporti i Auditorit të Pavarur

Pasqyrat Financiare

Faqe

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

1

Pasqyra e Pozicionit Financiar

2

Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet

3

Pasqyra e Rrjedhës së Parasë

4

Shënime për Pasqyrat Financiare

5-59

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Aksionerëve të Banka për Biznes Sh.a

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Banka për Biznes Sh.a (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2017, dhe pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2017, dhe të rezultatit të saj financiar dhe rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA-të"). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël ("Kodi BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbyshur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera të përfshira në Raportin Vjetor të vitit 2017 të Banka për Biznes Sh.a

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Bankës për vitin 2017, përveç pasqyrave financiare të veqanta dhe këtij raporti të auditorit. Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Bankës për vitin 2017 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti auditimi.

Opinionit ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësini të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare (vijon)

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur menaxhmenti synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë.

Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA- të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Banka të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e Banka për Biznes Sh.a, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young Certified Auditors Kosovo
Ernst & Young Certified Auditors Kosovo shpk

17 prill 2018,
Prishtinë, Kosovo

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017


<i>Në mijë Euro</i>	Shënime	2017	2016
Të ardhurat nga interesi	6	11,387	9,821
Shpenzimet e interesit	6	(1,741)	(1,670)
Të ardhurat neto nga interesi		9,646	8,151
Të ardhurat nga tarifa dhe komisionet	7	2,309	2,000
Shpenzimet nga tarifa dhe komisionet	7	(653)	(522)
Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisionet		1,656	1,478
Kthimi nga kreditë e shlyera		690	583
Fitimi neto nga këmbimi valutor		12	(2)
Fitimi nga shitja e letrave me vlerë	14	1,065	1,878
Të ardhurat tjera operative	8	790	35
Gjithsej të ardhurat operative		13,859	12,123
Humbjet nga kreditë e rëna në vlerë	15	(543)	(830)
Kthimi i provizionit për kërkesat ndaj garancioneve		27	10
Ulja e vlerës së pasurive të riposeduara	18	(197)	(529)
Provizione tjera	23	(123)	(622)
Shpenzime tjera operative	9	(6,885)	(5,622)
Gjithsej shpenzimet operative		(7,721)	(7,593)
Fitimi para tatimit		6,138	4,530
Shpenzimet e tatimit në fitim	10	(631)	(387)
Fitimi neto për vitin		5,507	4,143
Të ardhurat gjithëpërfshirëse			
<i>Zërat që janë ose mund të ri-klasifikohen në fitim apo humbje</i>			
Rezerva për vlerën e drejtë (pasuritë financiare për shitje)		2	(14)
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		5,509	4,129


Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse lexohet së bashku me shënimet e shpalosura nga faqe 5 deri në faqen 59, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 dhjetor 2017

<i>Në mijë Euro</i>	Shënime	2017	2016
Pasuritë			
Paraja e gatshme dhe në banka	11	17,833	12,691
Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës	12	33,998	27,248
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	13	1,450	600
Letrat më vlerë të mbajtura për shitje	14	17,152	18,267
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	15	132,551	103,149
Pasuritë tjera financiare	16	143	237
Pasuritë tjera	17	815	141
Pasuritë e riposeduara	18	155	898
Pasuritë e paprekshme	19	338	226
Prona dhe pajisjet	20	1,725	980
Gjithsej pasuritë		206,160	164,437
Detyrimet			
Depozitat nga klientët	21	177,780	140,598
Kreditë e varura	22	840	1,845
Huamarrjet	22	4,143	4,248
Detyrime tjera	23	1,673	1,346
Provizione tjera	23	506	404
Detyrime për tatimin e shtyrë	10	124	126
Gjithsej detyrimet		185,066	148,567
Ekuiteti			
Kapitali aksionar	24	11,247	11,247
Rezerva tjera	24	857	857
Rezerva për rivlerësim	24	96	96
Rezerva për vlerën e drejtë		(30)	(32)
Fitimi i akumuluar		8,924	3,702
Gjithsej ekuiteti		21,094	15,870
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti		206,160	164,437

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga menaxhmenti i Bankës më 10 prill 2018 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:


Arton Celina
Kryeshef Ekzekutiv


Avni Berisha
Udhëheqës i Departamentit të
Financave

Pasqyra e pozicionit financiar lexohet së bashku me shënimet e shpalosura nga faqe 5 deri në faqen 59, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka për Biznes Sh.a.
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

<i>Në mijë Euro</i>	Kapitali aksionar	Rezerva tjera	Rezerva për rivlerësim	Fitimi / (humbja) e akumuluar	Rezerva për vlerën e drejtë	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2016	11,247	857	96	(441)	(18)	11,741
Transaksionet me aksionarët e Bankës						
<i>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</i>						
Rezerva e rivlerësimit	-	-	-	-	-	-
Fitimi i vitit	-	-	-	4,143	-	4,143
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	(14)	(14)
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	-	-	-	4,143	(14)	4,129
Gjendja më 31 dhjetor 2016	11,247	857	96	3,702	(32)	15,870
Transaksionet me aksionarët e bankës						
Dividenda për aksionarët e Bankës	-	-	-	(285)	-	(285)
<i>Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse</i>						
Fitimi i vitit	-	-	-	5,507	-	5,507
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-	2	2
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse	-	-	-	5,222	2	5,224
Gjendja më 31 dhjetor 2017	11,247	857	96	8,924	(30)	21,094

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet lexohet së bashku me shënimet e shpalosura nga faqe 5 deri ne faqen 59, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka për Biznes Sh.a.**Pasqyra e Rrjedhës së Parasë**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

<i>Në mijë Euro</i>	Shënime	2017	2016
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi i vitit para tatimit		6,138	4,530
<i>Zërat jo-monetar në pasqyra financiare:</i>			
Zhvlerësimi	20	351	321
Amortizimi	19	133	77
Fitimi nga shitja e pronave dhe pajisjeve dhe pasurive të riposeduara		(160)	(21)
Fitimi nga riposedimi i kolateralit		(601)	-
Humbjet nga kreditë të rëna në vlerë	15	543	830
Rënia në vlerë për pasuritë e riposeduara	18	197	529
Provizione tjera		123	395
Fitimi nga shitja e letrave me vlerë		(1,065)	(1,878)
Shpenzimet e interesit	6	1,741	1,670
Të ardhurat nga interesi	6	(11,387)	(9,821)
		(3,987)	(3,368)
Ndryshimet në:			
Kredi dhe paradhënie për bankat	13	(850)	360
Kredi dhe paradhënie për klientët	15	(28,884)	(16,524)
Rezerva e detyrueshme në BQK	12	(2,674)	(3,248)
Pasuri tjera	17	(674)	(19)
Pasuri tjera financiare	16	94	54
Pasuritë e riposeduara	18	694	-
Depozitat nga klientët	21	37,056	24,723
Detyrime tjera dhe provizione		313	643
Interesi i arkëtuar		11,288	9,967
Interesi i paguar		(1,746)	(1,684)
Tatimi në fitim i paguar		(565)	(290)
		10,065	10,614
Neto paraja e gjeneruar në aktivitete operative			
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Të hyrat /(Investimet) në pasuritë financiare të mbajtura për shitje		1,886	(7,927)
Blerja e pronave dhe pajisjeve	20	(1,105)	(276)
Blerja e pasurive të paprekshme	19	(245)	(156)
Të hyrat nga shitja e pronave dhe pajisjeve		2	37
		538	(8,322)
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet investuese			
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Pagesa e huamarrjeve	22	(2,600)	(800)
Inkasimet nga huamarrjet	22	1,500	2,000
Dividenda e shperndarë		(285)	-
		(1,385)	1,200
Paraja neto e gjeneruar nga aktivitetet financuese			
		9,218	3,492
Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të parasë			
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	11	27,646	24,154
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	11	36,864	27,646

Pasqyra e rrjedhës së parasë lexohet së bashku me shënimet e shpalosura nga faqe 5 deri në faqen 59, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

1. HYRJE

Banka Private e Biznesit Sh.a ka marrë licencën për aktivitete bankare me 29 mars 2001 dhe ka filluar operimin me 24 prill 2001.

Bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve më 28 shkurt 2005 dhe pas miratimit final nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK") më datë 22 mars 2005, Banka ka ndryshuar emrin nga Banka Private e Biznesit në Banka për Biznes ("Banka"). Në vitin 2006, Banka është regjistruar si shoqëri aksionare ("Sh.a"). Banka operon si një bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e konsumatorëve brenda Kosovës nëpërmjet rrjetit të 8 degëve dhe 19 nën degëve të saj të vendosura në Kosovë (2016: 7 degëve dhe 19 nën degë).

2. BAZAT E PËRGATITJES

a) Pasqyra e pajtueshmerisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

b) Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç pasurive financiare të mbajtura për shitje të cilat janë matur me vlerën e drejtë.

c) Valuta funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro e cila është valuta funksionale e Bankës. Të gjitha shumat janë rumbullaksuar në mijëshen më të afërt, përveç nëse është cekur ndryshe.

d) Përdorimi i gjykimeve dhe i vlerësimeve

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare, manaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe mbi shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të kenë ndryshim nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Informacionet mbi elementet e rëndësishme me pasiguri në vlerësime dhe mbi gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël me efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet 4, 5 dhe 26.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

Politikat e kontabilitetit të paraqitura me poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

a) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje me metodën efektive të interesit. Norma e interesit efektiv është norma që bënë aktualizimin e rrjedhave të pagesave dhe arkëtimeve të pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pritshme të pasurisë ose detyrimit financiar (ose sipas rastit mund të jetë një periudhë më e shkurtër) deri në shumën e bartur të pasurisë ose detyrimit financiar. Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit, Banka vlerëson rrjedhat monetare të ardhshme duke marrë parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar por jo humbjet e ardhshme të kredisë.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshinë të gjitha kostot e transaksionit dhe komisionet e zbritjet e tjera të paguara ose pranuar, të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që janë direkt të lidhura me blerjen apo emetimin e një pasurie apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse përfshijnë:

- Interesat nga pasuri ose detyrime financiare të matura me koston e amortizuar të llogaritur mbi bazën e interesit efektiv dhe;
- Interesat nga investime të vlefshme për shitje të llogaritura mbi bazën e interesit efektiv.

b) Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifrat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit në një pasuri ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhurat e tjera nga tarifrat dhe komisionet përfshirë; edhe tarifrat e shërbimeve të llogarive, tarifrat e transferimit të fondeve, komisione shitjesh dhe tarifa për vendosje me afat në banka njihen me kryerjen e shërbimeve të lidhura me to. Kur një zotim për kreditim nuk pritet të rezultojë në tërheqje të kredisë, komisionet e kredisë përkatëse njihen në bazë lineare përgjatë periudhës së angazhimit.

Shpenzimet e tjera për tarifrat dhe komisionet lidhen kryesisht me komisione për transaksione dhe shërbime, të cilat regjistrohen si shpenzim në momentin e pranimit të shërbimit.

c) Pagesat e qirasë

Pagesat për qiranë operative njihen në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë afatit të qirasë. Zbritjet nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimeve për qira, përgjatë afatit të qirasë.

d) Shpenzimet e tatimit

Shpenzimet e tatimit përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes të periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në ekuitet ose në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përfshin tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet për të ardhurat e tatueshme ose humbjet për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose të arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

d) Shpenzimet e tatimit (vazhdim)

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet mbi diferencat e përkohshme që dalin midis bazës tatimore dhe vlerës kontabël neto të pasurive dhe detyrimeve në pasqyra financiare. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme që lindin në momentin e njohjes fillestare të pasurive ose detyrimeve të transaksioneve që nuk përbëjnë një kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as në fitimin/humbjen kontabël dhe as në atë të tatueshme.

Matja e tatimit të shtyrë reflekton pasojat tatimore që do ta percjellin menyrën në të cilën banka pret në fund të periudhës raportuese që të mbulojë apo vendos vlerën kontabël të mjeteve dhe detyrimeve të saj.

Tatimi i shtyrë matet sipas normave tatimore që priten të aplikohen në diferencat e përkohshme kur ato kthehen, përmes normave tatimore në fuqi në datën e raportimit.

Pasuritë dhe detyrimet tatimore të shtyera netohen ndërmjet tyre nëse ka një të drejtë ligjore për ta netuar me pasurinë dhe detyrimin e tatimit dhe kur ndërliiden me tatimet e pagueshme kundrejt autoritetit të njëjtë tatimor.

Tatimet shtesë që vijnë si rezultat i shpërndarjes së dividendës nga ana e bankës njihen në të njëjtën kohë kur edhe njihen detyrimet për ta paguar dividendën respektive.

Një pasuri tatimore e shtyrë njihet për humbjet sipas tatimeve, kredive tatimore dhe dallimet e përkohshme të zbritshme të pashfrytëzuara, vetëm në atë masë që është e mundur të shfrytëzohet për fitimet e ardhshme të tatueshme, kundër të cilave mund të shfrytëzohet kjo pasuri. Pasuritë e tatimit të shtyrë rishikohen në secilën datë të raportimit dhe reduktohen në atë masë që nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi të realizohen.

(iii) Ekspozimet tatimore

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse tatimi apo interesat shtesë mund të jenë të pagueshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh në lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacione të reja mund të bëhen të disponueshme dhe të bëjnë që Banka të ndryshojë vendimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë në shpenzimet tatimore të periudhës në të cilën është bërë një përcaktim i tillë.

e) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj rivlerësohen në valutën funksionale përkatëse të Bankës në kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet në valutë të huaj në datën e raportimit konvertohen në valutën funksionale me kursin e këmbimit të normës së këmbimit në po atë datë.

Fitimi ose humbja nga zërat monetar është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në valutën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe kostos së amortizuar në valutë të huaj me kursin e këmbimit në fundin e vitit.

Pasuritë dhe detyrimet jo-monetare në valutë të huaj që maten me vlerën e drejtë, janë konvertuar në valutën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetar që maten në bazë të kostos historike në valutë të huaj, konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat që lindin nga rivlerësimi njihen në fitim ose humbje.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht njeh kreditë dhe paradhëniet, investimet e mbajtura deri në maturitet dhe të vlefshme për shitje, depozitat, huamarrjet dhe kreditë e varura në datën që ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e pasurive financiare njihen në datën e tregtimit në të cilën banka zotohet për të blerë ose shitur pasurinë. Të gjitha pasuritë dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, e cila është data kur Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Një pasuri ose detyrim financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit që lidhen drejtpërdrejtë me blerjen apo lëshimin e tij.

(ii) Klasifikimi

Pasuritë financiare

Banka klasifikon pasuritë e saj financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- Hua dhe llogari të arkëtueshme;
- Letrat më vlerë të mbajtura për shitje

Shiko shënimet 3.(h), dhe (i)

Detyrimet financiare

Banka klasifikon detyrimet e saj financiare si të matura me kosto të amortizuar.

(iii) Çregjistrimi

Pasuritë financiare

Banka e çregjistron një pasuri financiare kur të drejtat kontraktuese mbi rrjedhat e parasë nga pasuria financiare mbarojnë, ose kur transferon të drejtat për të marrë rrjedhat monetare kontraktuese në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë të pasurisë financiare janë transferuar apo në të cilin Banka as nuk transferon, as nuk mban thelbësisht të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk e mban kontrollin e pasurisë financiare. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që kualifikohen për çregjistrim që është krijuar apo mbajtur nga Banka njihet si një pasuri ose detyrim më vete.

Me çregjistrimin e pasurisë financiare diferenca ndërmjet vlerës bartëse të pasurisë (ose vlera e bartur e ndarë për pjesën e pasurisë që po çregjistrohet) dhe shumës së konsideratës së pranuar (i) (përfshirë çdo pasuri të re të përfituar minus çdo detyrim të ri të marrë përsipër) dhe (ii) dhe çdo fitimi ose humbje kumulative që është njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, njihet në fitim ose humbje.

Detyrimet financiare

Banka çregjistron një detyrim financiar kur obligimet kontraktuale përfundojnë apo anulohen, apo u skadon afati.

(iv) Netimi

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare netohen reciprokisht dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e gjendjes financiare kur, dhe vetëm kur, Banka ka të drejtë ligjore për të kompensuar shumat dhe synon ose t'i shlyejë ato në bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe ta shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF, apo për fitimet dhe humbjet që vijnë nga një grup i transaksioneve të ngjashme sikurse nga aktiviteti komercial i bankës.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë dhe detyrimet financiare (vazhdim)

Detyrimet financiare (vazhdim)

(v) *Matja e kostos së amortizuar*

“Kostoja e amortizuar” e një pasurie financiare ose detyrimi financiar është shuma me të cilën pasuria financiare ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare minus shlyerjet e kryegjësë, plus ose minus amortizimi i akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus zbritjet eventuale për shkak të rënies në vlerë.

(vi) *Matja e vlerës së drejtë*

“Vlera e drejtë” është çmimi që do të merrej nëse shitet një pasuri ose që do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në tregun kryesor ose, në mungesë të tij, tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron riskun e mosekzekutimit të tij.

Kur ka mundësi, Banka matë vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për atë instrument. Tregu konsiderohet aktiv nëse transaksionet për pasurinë ose detyrimin zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të ofruar informata për çmimet në bazë të vazhdueshme.

Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatës të vëzhgueshëm dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshëm. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshinë të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh gjatë vendosjes së çmimit të një transaksioni.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit – d.m.th. vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë. Nëse banka përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk dëshmohet as me çmim të kuotuar në treg aktiv për një pasuri ose detyrim identik dhe as në bazë të një teknike vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregje të vëzhgueshme, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, të korrigjuar për të shtyrë dallimin ndërmjet vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, ky dallim njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi përkrahet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni të mbyllet.

Në qoftë se një pasuri ose detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim të ofertës dhe një çmim të kërkesës, atëherë Banka matë pasuritë dhe pozicionet afatgjata me çmimin e ofertës dhe detyrimet dhe pozicionet afatshkurtra me çmimin e kërkesës.

Vlera e drejtë e depozitës sipas kërkesës nuk është më pak se shuma e pagueshme sipas kërkesës, e skontuar nga data e parë në të cilën shuma mund të kërkohet për t’u paguar.

Banka njuh transferet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDESISHME KONTABËL (vazhdim)

f) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Kreditë dhe paradhëniet e rëna në vlerë

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që pasuritë financiare, të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, janë provizionuar. Një pasuri financiare ose një grup pasurish financiare janë provizionuar kur evidenca objektive demonstroi se një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të pasurisë dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në rrjedhat e ardhshme monetare të pasurisë ose grupeve të pasurive dhe që mund të vlerësohet me besueshmëri.

Evidenca objektive që pasuritë financiare janë provizionuar mund të përfshijë vështirësi financiare të konsiderueshme të huamarrësit ose emetuesit, mospagesa nga huamarrësit, ristrukturimin e një kredie apo paradhënie nga Banka me kushte që Banka nuk do t'i kishte konsideruar, indikacione që një huamarrës ose huadhënës po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për një letër me vlerë ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup pasurish të tilla si ndryshimet negative në statusin e pagesave të huamarrësit ose emetuesit në grup apo kushtet ekonomike që lidhen me dështimin në bankë. Banka konsideron dëshmitë për provizionimin e kredive dhe paradhënieve si në nivel individual ashtu edhe në nivel grupi. Të gjitha kreditë dhe paradhëniet individualisht të rëndësishme vlerësohen për zhvlerësim specifik. Ato të cilat nuk janë të zhvlerësuara në mënyre specifike, vlerësohen në grup për çdo zhvlerësim të ndodhur, por për të cilin nuk janë identifikuar akoma.

Për qëllime të vlerësimit kolektiv të provizionimit, pasuritë financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të riskut të kredisë (llojin dhe shumën e kredisë). Bazuar në të dhënat historike për secilin prej grupeve llogaritet një faktor i humbjes. Këta faktor të pritshëm të humbjes janë rregulluar me gjykimin e drejtimit nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kredisë janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se tendencat historike dhe më pas ato janë aplikuar për të vlerësuar humbje nga zhvlerësimi në secilin grup. Normat e dështimit në pagesë, normat e humbjes dhe koha e pritshme e rikuperimeve të ardhshme krahasohen rregullisht kundrejt rezultateve aktuale për tu siguruar që ato vazhdojnë të jenë të përshtatshme. Humbja nga pasuritë e rëna në vlerë sipas kostos së amortizuar llogaritet si diferencë mes vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të rrjedhave monetare të ardhshme të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të pasurisë. Nëse kushtet e një pasurie financiare janë rinegociuar ose modifikuar ose një pasuri financiare ekzistuese është zëvendësuar me një të re për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë bëhet një vlerësim për të përcaktuar nëse pasuria financiare duhet të çregjistrohet ose jo. Nëse rrjedhat monetare të pasurisë të rinegociueshme ndryshojnë rrënjësisht, atëherë të drejtat kontraktuale ndaj rrjedhat monetare nga pasuria financiare fillestare konsiderohen të skaduara. Në këtë rast pasuria financiare origjinale çregjistrohet dhe pasuria e re financiare njihet me vlerën e drejtë.

Humbja nga rënia në vlerë matet si me poshtë:

- Në qoftë se ristrukturimi i prituri nuk çon në çregjistrim të pasurisë ekzistuese, rrjedhat e vlerësuara të mjeteve monetare që rrjedhin nga pasuria financiare e modifikuar përfshihen në matjen e pasurisë ekzistuese bazuar në kohën e prituri dhe të shumave të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të pasurisë financiar ekzistues.
- Në qoftë se ristrukturimi i prituri rezultoi në çregjistrim të pasurisë ekzistues, atëherë vlera e prituri e drejtë e aktivitetit të ri trajtohet si rrjedha monetare e fundit nga pasuria financiar ekzistues në kohën e çregjistrimit të tij. Kjo shumë është e skontuar nga data e pritshme e çregjistrimit në datën e raportimit, duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv të pasurisë financiar.

Humbjet nga rënia në vlerë njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari zbritje përkundrejt huave dhe paradhënieve. Interesi mbi pasuritë e provizionuara vazhdon të njihet nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje që ndodh pas njohjes së provizionimit, shkakton ulje në humbjen nga provizionimi, atëherë ulja e humbjes nga provizionimi rimerret nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

f) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

Kreditë e rëna në vlerë dhe paradhëniet (vazhdim)

Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari zbritje kundrejt huave dhe paradhënieve. Kreditë fshihen atëherë pasi janë ndërmarrur masa të arsyeshme të mbledhjeve në përputhje me politiken e përcaktuar të Bankës. Kur një ngjarje pasuese shkakton ulje të shumës së zhvlerësimit, ulja e humbjes nga provizionimi rimerret nëpërmjet fitimit ose humbjes.

Pasuritë financiare të mbajtura për shitje të rëna në vlerë

Banka vlerëson në çdo datë raportimi nëse ka evidence objektive që një pasuri financiare ose një grup pasurish financiare janë të rëna në vlerë. Në rast të investimeve në kapital të klasifikuara për shitje, një rënie e ndjeshme ose e shtrirë në vlerën e drejtë të letrave me vlerë nën koston e tij është konsideruar në përcaktimin nëse pasuritë janë të rëna në vlerë ose jo. Në qoftë se, në një periudhë vijuese, vlera e drejtë e një instrumenti të borxhit të klasifikuar si i vlefshëm për shitje rritet dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas humbjes nga zhvlerësimi, është njohur në fitim ose humbje. Humbja nga provizionimi kthehet nëpërmjet fitimit ose humbjes.

g) Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë monedha dhe kartmonedha në arkë, gjendja në Bankën Qendrore, mjete këto të pakufizuara në përdorim dhe pasurive financiare shume likuide me maturim fillestar deri në tre muaj të cilat, kanë risk të pakonsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë, dhe përdoren nga Banka për manaxhimin e angazhimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

h) Letrat me vlerë të mbajtura për shitje

Letrat me vlerë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit.

Investimet e mbajtura për shitje janë investime jo-derivative të cilat janë përcaktuar si të mbajtura për shitje ose nuk janë klasifikuar si një kategori tjetër e pasurive financiare. Investimet e mbajtura për shitje përbëhen nga letrat me vlerë të borxhit. Të gjitha investimet e mbajtura për shitje janë matur me vlerën e drejtë, pas njohjes fillestare.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga këmbimi valutor në investimet e vlefshme për shitje njihen në fitim ose humbje. Humbjet nga provizionimi njihen në fitim ose humbje (shih (f)(vii)).

Ndryshime tjera të vlerës së drejtë, përveç humbjeve nga provizionimi (shih (f)(vii)), njihen në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse dhe paraqiten në rezervën e vlerës së drejtë brenda ekuitetit. Kur investimi shitet, fitimi ose humbja e akumuluar në ekuitet riklasifikohet në fitim ose humbje.

i) Kreditë dhe të arkëtueshmet

Kreditë dhe të arkëtueshmet janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në një treg aktiv dhe Banka nuk ka për qëllim t'i shes menjëherë apo në një periudhë afatshkurtër. Kreditë dhe paradhëniet për bankat dhe klientët janë klasifikuar si kredi dhe të arkëtueshme.

Kreditë dhe paradhëniet njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot direkte të transaksionit dhe më pas vlerësohen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

j) Depozitat, huamarrjet dhe kreditë e varura

Depozitat, huamarrjet dhe kreditë e varura janë burimet kryesore të Bankës për financim. Depozitat, huamarrjet dhe kreditë e varura maten me vlerën e drejtë minus kostot direkte të transaksionit dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

k) Pasuritë e riposeduara

Pasuritë e riposeduara janë përfituar nëpërmjet ekzekutimit të kolateralit për kreditë dhe paradhëniet me probleme për klientët dhe që nuk fitojnë qira, nuk janë të përdorura nga Banka dhe janë të destinuara për shitje në një periudhë kohore të arsyeshme afatshkurtër. Pasuritë e riposeduara maten sipas vlerës më të ulët të koston dhe vlerës neto të realizueshme dhe çdo provizionim njihet në fitim ose humbje.

l) Prona dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve janë matur sipas koston minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet nga dëmtimet.

Kosto historike përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e pasurisë. Softueri i blerë që është thelbësor për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj pajisje.

Kur pjesë të një elementi të pasurive afatgjata kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si artikuj të veçantë (përbërësit madhor) të pronës dhe pajisjeve.

Çdo fitim ose humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit të një zëri të pronës dhe pajisjeve (llogaritur si diference mes të ardhurave neto nga shitja dhe vlerës kontabël neto të zërit), njihet në të ardhura të tjera në fitim ose humbje.

(ii) Kostot pasuese

Kostot pasuese kapitalizohen vetëm kur vërtetohet që përfitime ekonomike të ardhshme të atij shpenzimi do të rrjedhin në bankë. Riparimet e vazhdueshme dhe mirëmbajtja janë ngarkuar në shpenzime në periudhën që kanë ndodhur.

(iii) Zhvlerësimi

Zërat e pronës dhe pajisjeve zhvlerësohen nga data kur ato janë të vlefshme për përdorim. Zhvlerësimi llogaritet për të shlyer koston e artikujve të pronës dhe pajisjeve minus vlerat e përlllogaritura të mbetura të këtyre pasurive përgjate jetës së parashikuar të përdorimit. Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje.

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë jetëgjatësisë së çdo pjese të një zëri të pronës dhe pajisjeve. Jetëgjatësia e vlerësuar për periudhën aktuale dhe krahasuese është si vijon:

	Jetëgjatësia
Ndërtesa	20 vite
Kompjuterat dhe pajisje të ngjashme	5 vite
Automjete	5 vite
Mobilje dhe pajisje	5 vite

Përmirësimet e objekteve me qira zhvlerësohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit gjatë afatit më të shkurtër të qirasë dhe të jetës së tyre të dobishme. Jetëgjatësia e përmirësimeve në objektet e marra me qira është 5 vite.

Metodat e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlerat e mbetura janë rivlerësuar në datën e raportimit dhe rregulluar atëherë kur duhet.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

m) Pasuritë e paprekshme

Softuerët e blerë nga Banka janë matur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe minus ndonjë humbje nga rënia në vlerë. Shpenzimet pasuese mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike në pasurinë specifike më të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet tjera njihen kur ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje gjatë jetës së dobishme të pasurisë, që nga data që është i vlefshëm për përdorim.

Softueri amortizohet duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së dobishme për pesë vite. Metodatat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme.

n) Rënia në vlerë e pasurive jo financiare

Vlera kontabël e pasurive jo-financiare të bankës, përveç pasurive për tatime të shtyra, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e pasurisë. Një humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare të tij e tejkalon shumën e tij të rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të parasë është më e madhja nga vlera e tij në përdorim dhe vlera e drejtë minus kostoja për shitje. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhat e mjeteve monetare të ardhshme janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflektojnë vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike që lidhen me pasurinë.

Humbjet nga dëmtimi janë njohur në fitim apo humbje. Humbja nga rënia në vlerë kthehet deri në atë masë sa vlera kontabël e pasurisë nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, në qoftë se nuk është njohur humbja nga zhvlerësimi.

o) Provizionet

Një provizion njihet si pasojë e një ngjarje të mëparshme, ku Banka ka një obligim ligjor aktual apo konstruktiv që mund të vlerësohet me saktësi dhe ka mundësi që një dalje e mjeteve monetare do të kërkohej për të shlyer obligimin. Provizionet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të pritura të pasurive monetare me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën e parasë në kohë dhe sipas rastit, me risqet specifike të detyrimit. Skontimi i pashmangshëm njihet si kosto financiare.

p) Përfitimet e punonjësve

(i) Planet e përcaktuara të kontributeve

Detyrimet për kontributet në planet e përcaktuara të kontributeve njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Banka paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme që ofrojnë përfitime në formë të pensioneve për punonjësit me rastin e pensionimit. Autoritetet vendore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani të përcaktuar të kontributeve për pensione.

(ii) Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punëtorëve maten mbi një bazë të paskontuar dhe njihen si shpenzime me momentin e ofrimit të shërbimit. Një provizion njihet për shumën që pritet të paguhet sipas një bonusi afatshkurtër në të holla ose sipas planit për ndarjen e fitimit nëse banka ka një detyrim ligjor aktual ose konstruktiv për të paguar këtë vlerë si rezultat i shërbimeve në të kaluarën të ofruara nga punonjësi me ç'rast detyrimi mund të vlerësohet me saktësi.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

q) Garancionet financiare dhe zotimet për kreditë

Garancionet financiare janë kontrata që e detyrojnë Bankën që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës. Zotimet për hua janë angazhimet e përcaktuara për të siguruar kredi sipas termave dhe kushteve të para-përcaktuara. Angazhime të tilla financiare regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar, nëse dhe kur ato bëhen të pagueshme.

r) Dividenda

Dividenda nga aksionet e zakonshme njihen në kapital në periudhën në të cilën ato janë miratuar nga aksionarët e bankës. Dividenda për vitin që janë deklaruar pas datës së raportimit janë paraqitur si ngjarje pas përfundimit të periudhës së raportimit.

Një numër standardesh të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende efektive për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe nuk janë zbatuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Ato që mund të jenë relevante për Bankën janë paraqitur më poshtë. Banka nuk planifikon të miratojë këto standarde dhe ndryshime të hershme.

Standardet dhe interpretimet që janë lëshuar, por që nuk janë ende efektive, deri në datën e publikimit të pasqyrave financiare të Bankës janë dhënë më poshtë. Banka synon të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

s) Rezervat e ekuitetit

Rezervat e regjistruara në ekuitet në pasqyrën e pozicionit financiar të bankës përbëhen nga:

- Rezerva letrave me vlerë të mbajtura për shitje, që përfshin ndryshimet në vlerën e drejtë të investimeve të gatshme për shitje;
- Rezerva tjetër e ekuitetit, që përfshin dallimin ndërmjet humbjeve të akumuluar sipas SNRF dhe BQK;
- Rezerva e rivlerësimit, që përfshin kolateralin e riposeduar të regjistruar në pasuri dhe pajisje nga Banka.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

4. ADAPTIMI DHE INTERPRETIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA

4.1 Standardet dhe interpretimet e miratuara, por ende jo efektive

Një numër standardesh të reja, ndryshime në standarde dhe interpretime nuk janë ende efektive për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 dhe nuk janë zbatuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Banka nuk planifikon të zbatojë këto standarde dhe ndryshime përpara datave të tyre efektive.

SNRF 9 Instrumentet financiare

Në korrik 2014, IASB publikoi versionin përfundimtar të SNRF 9 Instrumentat Financiare. SNRF 9 hyn në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, me mundësinë për adaptim më të hershëm. Ai zëvendëson IAS 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja.

Në tetor 2017, IASB publikoi Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshime në SNRF 9). Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, me mundësinë për adaptim më të hershëm.

Banka do të zbatojë SNRF 9, miratuar në korrik 2014, fillimisht më 1 janar 2018 dhe do të kryej korigjimet sipas ndryshimeve SNRF 9 më 1 janar 2019. Bazuar në vlerësimet e ndërmarra deri më sot, Banka vlerëson se adaptimi i SNRF 9 më 1 janar 2018, nuk do të sjellë ndryshime në klasifikimin dhe matjen e pasurive financiare. Banka është në proces të vlerësimit të rezultateve paraprake lidhur me kërkesat për provizionim (shih (ii)). Banka pret që provizionimi i kredive dhe paradhëniesve ndaj klientëve dhe investimet në letrat me vlerë të borxhit të rriten, megjithatë në total, mos të tejkalojë provizionet aktuale të llogaritura për qëllime rregullatore, të cilat më 31 dhjetor 2017 janë 34% më të larta se provizionet e SNRF. Nga ana tjetër, investimet në letrat me vlerë të borxhit të Qeverisë së Kosovës nuk ofrohen sipas qëllimit rregullator, por këto investime nuk priten të kenë përkeqësuar riskun e kredisë dhe çdo dëmtrim do të llogaritet vetëm për 12 muaj humbje të pritshme.

Vlerësimi i mësipërm është paraprak sepse nuk janë finalizuar të gjitha aktivitetet lidhur me tranzicionin. Ndikimi aktual i adaptimit të SNRF 9 më 1 janar 2018 mund të ndryshojë sepse:

- SNRF 9 do të kërkojë nga Banka që të rishikojë proceset e saj të kontabilitetit dhe kontrollet e brendshme dhe këto ndryshime nuk janë ende të plota;
- Banka nuk ka përfunduar testimin dhe vlerësimin e kontrolleve mbi sistemet e reja të IT-së dhe ndryshimet në kornizën e saj të qeverisjes;
- Banka është në proces përmirësimit dhe finalizimi të modeleve të saj për llogaritjet e humbjeve të pritshme kreditore (HPK); dhe
- Politikat e reja kontabël, supozimet, gjykimet dhe teknikat e vlerësimit të përdorura mund të ndryshojnë derisa Banka të përfundojë pasqyrat e saj të para financiare që përfshijnë datën e aplikimit fillestar.

Ndryshimet në klasifikim dhe matje

SNRF 9 përmban një model të ri për klasifikimin dhe matjen e pasurive financiare, i cili pasqyron modelin e biznesit për menaxhimin e këtyre pasurive dhe karakteristikat të rrjedhës së parasë së gatshme.

SNRF 9 përfshin tre kategori kryesore për klasifikimin e pasurive financiare: të matura me koston e amortizuar, me vlerë të drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse (VDATGJ) dhe me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim-humbjes (VDPFH) dhe eliminon kategoritë ekzistuese të IAS 39 të mbajtura deri në maturim, kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme dhe të mbajtura për shitje.

Një pasuri financiare matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDPFH:

- është mbajtur në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e pasurive për mbledhjen e rrjedhat e parasë kontraktuale; dhe
- kushtet kontraktuale të saj specifikojnë datat për rrjedhat e parasë të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit (VPPI) në shumën e principalit të papaguar.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

4. ADAPTIMI DHE INTERPRETIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA (VAZHDIM)

4.1 Standardet dhe interpretimet e miratuara, por ende jo efektive (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentet financiare (vazhdim)

Ndryshimet në klasifikim dhe matje (vazhdim)

Një pasuri financiare matet në VDATGJ vetëm nëse plotëson të dyja këto kushte dhe nuk është përcaktuar si në VDPFH:

- është mbajtur në kuadër të një modeli biznesi objektiv i të cilit arrihet si nga mbledhja e rrjedhave të parasë kontraktuale dhe shitja e pasurive financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të saj specifikojnë datat për rrjedhat e parasë të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit (VPPI) në shumën e principalit të papaguar

Të gjitha pasuritë financiare që nuk klasifikohen si të matura me koston e amortizuar ose VDATGJ siç përshkruhen më lart, maten në VDPFH. Përveç kësaj, në njohjen fillestare, Banka mund të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një pasuri financiare si në VDPFH, pavarësisht se ai plotëson kërkesat që duhen për t'u matur me koston e amortizuar ose në VDATGJ, nëse ky klasifikim eliminon ose redukton ndjeshëm një mospërputhje kontabël që do të lindte në të kundërt.

Një pasuri financiare klasifikohet në një nga këto kategori në njohjen fillestare. Shihni (iii) për kërkesat e tranzicionit që kanë të bëjnë me klasifikimin e pasurive financiare.

Sipas SNRF 9, derivativët e përfshirë në kontratat ku mbajtësi është një pasuri financiar në fushën e SNRF 9 nuk janë të ndara. Në vend të kësaj, instrumenti financiar hibrid vlerësohet për klasifikim si një i tërë. Banka aktualisht nuk ka instrumente financiar derivative ose hibrid.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Banka do të bëjë një vlerësim të objektivit të modelit të biznesit, në të cilin një pasuri financiar mbahet në një nivel portofoli, sepse kjo më së miri reflekton mënyrën se si menaxhohet biznesi dhe informacioni i jepet menaxhmentit. Informacioni që do të konsiderohet përfshin:

- politikat dhe objektivat e përcaktuara për portofolin dhe funksionimin e këtyre politikave në praktikë, duke përfshirë nëse strategjia e menaxhmentit përqendrohet në fitimin e të ardhurave nga interesi kontraktual, duke ruajtur një profil të caktuar të normës së interesit, duke përputhur kohëzgjatjen e pasurive financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që po financojnë ato pasuri ose realizimi i rrjedhës së parasë nëpërmjet shitjes së pasurive;
- si vlerësohet dhe raportohet performanca e portofolit në menaxhmentin e Bankës;
- risqet që ndikojnë në ecurinë e modelit të biznesit (dhe pasurive financiare të mbajtura brenda atij modeli biznesi) dhe mënyrën se si menaxhohen ato risqe;
- se si menaxherët e biznesit janë kompensuar - p.sh. nëse kompensimi bazohet në rrjedhat e parasë kontraktuale të mbledhura ose në fitimin total të realizuar nga portofoli; dhe
- frekuenca, vëllimi dhe koha e shitjeve në periudhat e mëparshme, arsyet për shitjet e tilla dhe pritjet për aktivitetin e ardhshëm të shitjes. Megjithatë, informacioni rreth aktivitetit të shitjeve nuk konsiderohet në veçanti, por si pjesë e një vlerësimi të përgjithshëm se si është arritur objektivit i Bankës për menaxhimin e pasurive financiare dhe si realizohen rrjedhat e parasë.

Vlerësimi nëse rrjedhat e parasë kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit.

Për qëllimet e këtij vlerësimi, 'principal' përcaktohet si vlera e drejtë e pasurisë financiar në njohjen fillestare. "Interesi" përcaktohet si një shpërblim për vlerën në kohë të parasë, për riskun e kredisë që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe për risqet dhe kostot e tjera bazë të huadhënies (p.sh. risku i likuiditetit dhe kostot administrative), si edhe një marzhë fitimi.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

4. ADAPTIMI DHE INTERPRETIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA (VAZHDIM)

4.1 Standardet dhe interpretimet e miratuara, por ende jo efektive (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentet financiare (vazhdim)

Vlerësimi i modelit të biznesit (vazhdim)

Gjatë vlerësimit nëse rrjedhat e parasë kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, Banka do të marrë parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo do të përfshijë vlerësimin nëse pasuria financiare përmban një term kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e rrjedhës së parasë kontraktuale në mënyrë që të mos plotësojë këtë kusht. Gjatë bërjes së vlerësimit, Banka konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që do të ndryshonin shumën dhe kohën e rrjedhës së parasë;
- karakteristikat e borxhit;
- parapagimi dhe afati i zgjatjes;
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Bankës për rrjedhat e parasë nga pasuritë e specifikuar - p.sh. rregullimet e pasurive të jo-rekursit; dhe
- karakteristika që modifikojnë konsideratën për vlerën kohore të parasë - p.sh. rivendosjen periodike të normave të interesit.

Normat e interesit për kreditë me pakicë të bëra nga Banka janë të bazuara në normat fikse standarde të cilat janë vendosur në diskrecionin e Bankës. Në këto raste, Banka vlerëson nëse NFS është në përputhje me normat e tregut dhe i siguron Bankës kthime të mjaftueshme për të mbuluar:

- vlerën në kohë të parave,
- riskun e kredisë që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohe, dhe
- risqe të tjera bazë të huazimit dhe kosto, si dhe një marzh fitimi.

Të gjitha kreditë individuale të bankës përmbajnë karakteristika të parapagimit. Një tipar i parapagimit është në përputhje me kriterin e SPPI nëse shumat e parapagimit përfaqëson kryesisht shumën të papaguar të principalit dhe interesit mbi shumën principale të papaguar, që mund të përfshijë kompensim të arsyeshëm për përfundimin e parakohshëm të kontratës.

Vlerësimi i impaktit

Banka ka vlerësuar se adaptimi i SNRF 9 më 1 janar 2018 nuk do të sjellë ndryshime në matjen e saj aktuale të pasurive financiare sipas SNK 39. Klasifikimi i pasurive të saj financiare të mbajtura më 1 janar 2018 do të ndryshojë si më poshtë:

- Kreditë dhe paradhëniet për Bankat dhe klientët që klasifikohen si kredi dhe të arkëtueshmet të matura me koston e amortizuar sipas IAS 39 do të maten në përgjithësi me koston e amortizuar sipas SNRF 9.
- Letrat me vlerë të investimit të borxhit që klasifikohen si 'të mbajtura për shitje' sipas SNK 39 do të maten në VDATGJ, sipas SNRF 9, pasi këto pasuri plotësojnë kushtet e VPPI dhe modeli i tanishëm i biznesit të Bankës është që këto mjete të mbahen me qëllim të grumbullimit të rrjedhës së parasë kontraktuale dhe shitjen e pasurive financiare.

Ndryshimet në llogaritjen e provizionimit

SNRF 9 zëvendëson modelin e 'humbjeve të ndodhura' në IAS 39 me një model të 'humbjes së pritshme të kredisë' ('HPK') që shikon përpara. Kjo do të kërkojë gjykim të konsiderueshëm mbi atë se si ndryshimet në faktorët ekonomikë ndikojnë në HPK, të cilat do të përcaktohen në bazë të një peshimi me probabilitet.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

4. ADAPTIMI DHE INTERPRETIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA (VAZHDIM)

4.1 Standardet dhe interpretimet e miratuara, por ende jo efektive (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentet financiare (vazhdim)

Ndryshimet në llogaritjen e provizionimit (vazhdim)

Përveç kredive dhe llogarive të arkëtueshme, modeli i ri i provizionimit zbatohet edhe për instrumentet financiare që nuk maten në VDPFH:

- pasuritë financiare që janë instrumente borxhi; dhe
- angazhimet e huave dhe kontratat e garancisë financiare të lëshuara (më parë, zhvlerësimi është matur sipas *SNK 37 Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë Kontingjente*).

SNRF 9 kërkon që një humbje të njihet në një shumë të barabartë me HPK-të 12-mujore ose HPK-të e përjetshme, në varësi të vlerësimit të riskut të mospagimit/humbjes. HPK-të e përjetshme janë HPK-të që rezultojnë nga të gjitha ngjarjet e mundshme të mospagimit/humbjes gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar, ndërsa HPK-të 12-mujore janë pjesë e HPK-ve që rezultojnë nga ngjarjet e mospagimit/humbjes që janë të mundshme brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Banka do të njohë humbjet në një shumë të barabartë me HPK-të e përjetshme, përveç në rastet e mëposhtme, për të cilat shuma e njohur do të jetë HPK 12-mujore:

- letrat me vlerë të investimit të borxhit që përcaktohen të kenë risk të ulët të kredisë në datën e raportimit. Banka e konsideron një letër me vlerë të borxhit të ketë risk të ulët të kreditit, kur vlerësimi i riskut të tij të kredisë është ekuivalent me përkufizimin e kuptimit global të 'klasës së investimit'; dhe
- Kreditë dhe letrat me vlerë të investimit të borxhit, për të cilat risku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare.

Kërkesat për provizionim të SNRF 9 janë komplekse dhe kërkojnë gjykime, vlerësime dhe supozime të menaxhimit, veçanërisht në fushat e mëposhtme, të cilat diskutohen në detaje më poshtë:

- vlerësimi nëse risku i kredisë i një instrumenti është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare; dhe
- përfshirja e informacionit të parashikuar në matjen e HPK-ve.

HPK janë një vlerësim i ponderuar me probabilitet të humbjeve të kredive dhe do të maten si më poshtë:

- *pasuritë financiare që nuk janë të rëna në vlerë nga kreditë në datën e raportimit*: vlera aktuale e të gjitha mangësive në para të prekshme – dmth: diferenca midis rrjedhës së parasë që i detyrohen njësisë ekonomike në përputhje me kontratën dhe rrjedhës së parasë që Banka pret të marrë;
- *pasuritë financiare që janë të rëna në vlerë nga kreditë në datën e raportimit*: diferenca midis vlerës kontabël bruto dhe vlerës aktuale të rrjedhës së parasë të vlerësuar;
- *zotimet e huave të patërhequra*: vlera aktuale e diferencës ndërmjet rrjedhës së parasëkontraktuale që i detyrohen Bankës, nëse bëhet tërheqja e angazhimeve të kredisë dhe rrjedhës së parasë që Banka pret të marrë; dhe
- *kontratat e garancisë financiare*: vlera aktuale e pagesave të pritshme për të rimbursuar mbajtësin minus shumat që Banka pret të rikuperojë.

Pasuritë financiare që janë të provizionuara nga kredia janë përcaktuar nga SNRF 9 në një mënyrë të ngjashme me pasuri financiare të provizionuara sipas SNK 39. Sipas SNK 39, aktualisht nuk njihet asnjë provizion për zotimet e patërhequra të kredisë dhe kontratat e garancionit financiar, përveç nëse është vërejtur një evidencë provizionimi.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

4. ADAPTIMI DHE INTERPRETIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA (VAZHDIM)

4.1 Standardet dhe interpretimet e miratuara, por ende jo efektive (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentet financiare (vazhdim)

Përkufizimi i humbjeve

Sipas SNRF 9, Banka do të konsiderojë një pasuri financiare në humbje kur:

- huamarrësi nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e tij të kredisë në Bankë në tërësi, pa pasur nevojë nga ana e Bankës për veprime të tilla si realizimi i sigurisë (nëse ka ndonjë të tillë); ose
- huamarrësi ka më shumë se 90 ditë vonesa për çdo detyrim material kredie për Bankën.

Ky përkufizim është kryesisht në përputhje me përkufizimin e përdorur për qëllime rregullatore për kreditë e klasifikuara si 'të dyshimta' ose 'të humbura'.

Në vlerësimin nëse një huamarrës është në mospagim/humbje, Banka do të konsiderojë tregues që janë në përputhje me kërkesat rregullatore të riskut për klasifikimin e huave si 'të dyshimta' ose 'të humbura':

- cilësore: p.sh. shkeljet e marrëveshjes kontraktuale;
- sasiorë: p.sh. statusi i vonuar dhe mospagesa e një detyrimi tjetër të të njëjtit huamarrës në Bankë; dhe
- klasifikimi i riskut rregullator të të njëjtit huamarrës, në Banka të tjera.

Inputet në vlerësimin nëse një instrument financiar është në mospagim/humbje dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të pasqyruar ndryshimet në rrethanat.

Nivelet e riskut të kredisë

Banka cakton secilin ekspozim në një klasë të riskut të kredisë bazuar në kërkesat e përcaktuara nga rregullorja e Menaxhimit të Riskut të Kredisë, duke përdorur faktorë cilësorë dhe sasiorë që tregojnë riskun e mospagimit/humbjes. Krahas klasave të riskut të prezantuara për qëllime rregullatore, Banka identifikon dhe monitoron në mënyrë të ndarë kreditë standarde me ditëvonesa, nga kreditë standarde pa ditë vonesa.

Çdo ekspozim do të alokohet në një klasë të riskut të kredisë për njohjen fillestare, bazuar në informacionin në dispozicion për huamarrësin. Ekspozimet do të jenë subjekt i monitorimit të vazhdueshëm, i cili mund të rezultojë në një ekspozim të zhvendosur në një klasë tjetër të riskut të kredisë.

Përcaktimi nëse risku i kredisë është rritur ndjeshëm

Sipas SNRF 9, kur përcaktohet nëse risku i kredisë (dmth. risku i humbjes) të një instrumenti financiar është rritur dukshëm që nga njohja fillestare, Banka do të marrë parasysh informacione të arsyeshme dhe të mbështetshme që janë relevante dhe të disponueshme pa kosto dhe përpjekje të panevojshme, duke përfshirë informacion cilësor dhe sasior dhe analiza të bazuara në përvojën historike të Bankës, vlerësimin e ekspertëve të kredive dhe informacionin e ardhshëm.

Banka do të identifikojë kryesisht nëse ka ndodhur një rritje e ndjeshme e riskut të kredisë për një ekspozim që ndryshon klasifikimin e riskut rregullator nga 'standart' në 'në ndjekje' të vlerësuar në përputhje me politikën e Bankës për klasifikimin e riskut rregullator. Të gjitha kreditë që shfaqin rritje të konsiderueshme në riskun e kredisë klasifikohen në Fazën 2.

Si një përforsim, dhe siç kërkohet nga SNRF 9, Banka do të konsiderojë me siguri se një rritje e ndjeshme e riskut të kredisë ndodh jo më vonë se kur një aktiv është më shumë se 30 ditë vonesë. Banka do të përcaktojë ditë vonesat duke numëruar numrin e ditëve që nga data më e hershme e kaluar për të cilën nuk është marrë pagesa e plotë.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

4. ADAPTIMI DHE INTERPRETIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA (VAZHDIM)

4.1 Standardet dhe interpretimet e miratuara, por ende jo efektive (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentet financiare (vazhdim)

Përcaktimi nëse risku i kredisë është rritur ndjeshëm (vazhdim)

Banka do të monitorojë efektivitetin e kritereve të përdorura për të identifikuar rritje të ndjeshme të riskut të kredisë, nëpërmjet rishikimeve të rregullta për të konfirmuar se:

- kriteret janë në gjendje të identifikojnë rritje të ndjeshme në riskun e kredisë para se një ekspozim të kalojë në mospagim/humbje;
- koha mesatare midis identifikimit të një rritjeje të konsiderueshme të riskut të kredisë dhe mospagimit/humbjes duket e arsyeshme; dhe
- ekspozimet në përgjithësi nuk transferohen drejtpërdrejt nga matja e HPK 12-mujore në provizionim nga kredia.

Pasuritë financiare të modifikuara

Kushtet kontraktuale të një kredie mund të ndryshohen për një numër arsyesh, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut, mbajtjen e klientëve dhe faktorëve të tjerë që nuk lidhen me një përkeqësim aktual ose potencial të kredisë të klientit. Një kredi ekzistuese, kushtet e të cilave janë modifikuara, mund të çregjistrohen dhe kredia e rinegociuar të njihet si një kredi e re me vlerë të drejtë.

Sipas SNRF 9, kur kushtet e një pasurie financiare modifikohen dhe modifikimi nuk rezulton në ç'regjistrim, Banka do të shqyrtojë nëse risku i kredisë së pasurisë është rritur ndjeshëm duke analizuar faktorët sasiorë dhe cilësorë që ndikojnë në riskun e mospagimit/humbjes.

Banka rinegocion kreditë për klientët në vështirësi financiare (të referuara si 'aktivitete të ristrukturimit') për të maksimizuar mundësitë e grumbullimit dhe minimizuar riskun e mospagimit/humbjes. Sipas politikës së ristrukturimit të Bankës, ristrukturimi i huasë jepet në baza selektive nëse debitori momentalisht është në mospagim të borxhit të tij ose nëse ekziston një risk i lartë i mospagimit, ka dëshmi se debitori ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të paguar sipas kushteve të kontratës fillestare dhe debitori pritet të jetë në gjendje të përmbushë kushtet e rishikuara.

Termet e rishikuar zakonisht përfshijnë zgjatjen e maturitetit, ndryshimin e kohës së pagesave të interesit dhe ndryshimin e kushteve të marrëveshjes së kredisë. Të dy kreditë me pakicë (retail) dhe të biznesit janë subjekt i politikës së ristrukturimit. Në përgjithësi, ristrukturimi është një tregues cilësor i mospagimit/humbjes dhe provizionimit të kredisë dhe pritet të ristrukturimit janë relevante për të vlerësuar nëse ka një rritje të ndjeshme të kredisë.

Pas ristrukturimit, një klient duhet të tregojë sjellje të mirë të pagesave në mënyrë të qëndrueshme gjatë tetë muajve para se ekspozimi të matet në një shumë të barabartë me HPK-të 12-mujore. Ky supozim është gjithashtu në përputhje me udhëzimet rregullative.

Inputet kryesore në matjen e HPK-ve kanë të ngjarë të jenë strukturat e termave të variablave në vijim:

- PD;
- humbja e parikuperueshme (HPR); dhe
- ekspozimi në humbje (EMP).

Këto parametra do të rrjedhin nga modelet statistikore të zhvilluara brenda njësisë dhe të dhëna të tjera historike që përdorin modelet rregullatore. Ato do të rregullohen për të pasqyruar informacionin e ardhshëm, siç përshkruhet më poshtë.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

4. ADAPTIMI DHE INTERPRETIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA (VAZHDIM)

4.1 Standardet dhe interpretimet e miratuara, por ende jo efektive (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentet financiare (vazhdim)

Pasuritë financiare të modifikuara (vazhdim)

Inputet në matjen e HPKs

Nivelet e riskut të kredisë do të jenë një kontribut primar në përcaktimin e strukturës së termave të PD për ekspozimet. Banka do të përdorë modele statistikore për të analizuar të dhënat e mbledhura dhe për të gjeneruar vlerësime të PD-së së përjetshme të mbetur të ekspozimeve dhe se si këto pritet të ndryshojnë si pasojë e kalimit të kohës.

Kjo analizë do të përfshijë identifikimin dhe kalibrimin e marrëdhënieve midis ndryshimeve në normat e mospagimit/humbjes dhe ndryshimet në faktorët kryesorë makroekonomikë, si dhe analizën e thellë të ndikimit të disa faktorëve të tjerë (p.sh. përvojën e ristrukturimit) në riskun e mospagimit/humbjes. Për shumicën e ekspozimeve, treguesit kryesorë makroekonomikë ka të ngjarë të përfshijnë rritjen e PBB-së, normat e interesit dhe papunësinë. Qasja e Bankës për përfshirjen e informacioneve të ardhshme në këtë vlerësim është diskutuar më poshtë.

HPR është madhësia e humbjes së mundshme nëse ka një mospagim/humbje. Banka do të vlerësojë parametrat HPR bazuar në historinë e normave të rimëkëmbjes së kërkesave ndaj palëve që nuk paguajnë. Modelet HPR do të marrin në konsideratë strukturën, kolateralin, vjetërsinë e kërkesës dhe kostot e rimëkëmbjes të çdo kolaterali që është pjesë përbërëse e pasurisë financiar. Për kreditë e siguruara nga prona retail, raportet e kredisë për vlerën (LTV) ka gjasa të jenë një parametër kyç në përcaktimin e HPR.

Vlerësimet HPR do të kalibrohen për skenarë të ndryshëm ekonomikë dhe, për huadhënien e pasurive të paluajtshme, të pasqyrojnë ndryshimet e mundshme në çmimet e pronës. Ato do të llogariten mbi bazën e rrjedhës së parasë të skontuara duke përdorur normën efektive të interesit si faktor diskontimi.

EAD përfaqëson ekspozimin e pritur në rast të një mospagimi/humbjeje. Banka do të nxjerr EMP nga ekspozimi aktual ndaj palës tjetër dhe ndryshimet potenciale në shumën aktuale të lejuar sipas kontratës, përfshirë amortizimin dhe parapagimet. EMP -i i një pasurie financiare do të jetë vlera kontabël bruto në mospagim/humbje. Për zotimet e huadhënies dhe garancitë financiare, EMP do të shqyrtojë shumën e tërhequr, si dhe shumat potenciale të ardhshme që mund të tërhiqen ose ripaguhen sipas kontratës, të cilat do të vlerësohen bazuar në vërtetimet historike dhe parashikimet e ardhshme.

Banka do të masë HPK-të duke marrë në konsideratë riskun e mospagimit/humbjes për periudhën maksimale kontraktuale (duke përfshirë opsionet e zgjerimit të huamarrësit) mbi të cilën ai është i ekspozuar ndaj riskut të kredisë, edhe pse, për qëllime të administrimit të riskut, Banka konsideron një periudhë më të gjatë. Periudha maksimale kontraktuale zgjat deri në datën në të cilën Banka ka të drejtë të kërkojë kthimin e një paradhënie ose të ndërpresë një angazhim ose garanci kredie.

Për mbitërheqjet individuale dhe objektet e kartelës së kreditit dhe disa struktura rrotulluese të korporatave që përfshijnë si një hua, ashtu edhe një përbërës të angazhimit të patërhequr, Banka do të masë HPK -të për një periudhë më të gjatë se periudha maksimale kontraktuale, nëse aftësia kontraktuale e Bankës për të kërkuar shlyerjen dhe anulimin e zotimit të patërhequr nuk kufizon ekspozimin e Bankës ndaj humbjeve të kreditit në periudhën e njoftimit të kontratës. Këto objekte nuk kanë terma të caktuara ose strukturë të ripagimit dhe menaxhohen në baza kolektive.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

4. ADAPTIMI DHE INTERPRETIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA (VAZHDIM)

4.1 Standardet dhe interpretimet e miratuara, por ende jo efektive (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentet financiare (vazhdim)

Pasuritë financiare të modifikuara (vazhdim)

Banka mund t'i anulojë ato me efekt të menjëhershëm, por kjo e drejtë kontraktuale nuk zbatohet në menaxhimin normal të përditshëm, por vetëm kur Banka bëhet me dije për një rritje të riskut të kredisë në nivel të objektit. Kjo periudhë më e gjatë do të vlerësohet duke marrë parasysh veprimet e menaxhimit të riskut të kredisë që Banka pret të ndërmarrë dhe që shërbejnë për të zbutur HPK -të. Këto përfshijnë një ulje të limiteve dhe anulimin e objektit.

Kur modelimi i një parametri kryhet në baza kolektive, instrumentet financiare do të grupohen në bazë të karakteristikave të përbashkëta të riskut që përfshijnë: llojin e instrumentit; dhe klasifikimin e riskut të kredisë.

Grupimet do t'i nënshtrohen rishikimit të rregullt për të siguruar që ekspozimet brenda një grupi të caktuar të mbeten homogjene. Për investimet në letrat me vlerë të borxhit në lidhje me të cilat Banka ka të dhëna të kufizuara historike, informacionet e jashtme referuese të publikuara nga agjencitë e njohura të vlerësimit të jashtëm të kreditit të tilla si Moody's, do të përdoren për të plotësuar të dhënat në dispozicion brenda vendit.

Informacionet e ardhshme

Sipas SNRF 9, Banka do të inkorporojë informacione të ardhshme në të dyja vlerësimet e saj, pra nëse risku i kreditit i një instrumenti është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare dhe në matjen e ECL-së. Banka do të formulojë një 'pikëpamje bazë' për drejtimin e ardhshëm të variablave përkatës ekonomike dhe një gamë përfaqësuese të skenarëve të tjerë të mundshëm të parashikimit bazuar në këshillat e Komitetit të Riskut të Bankës dhe ekspertëve ekonomikë dhe shqyrtimin e një sërë informacionesh të jashtme aktuale dhe parashikuese. Ky proces do të përfshijë zhvillimin e dy ose më shumë skenarëve ekonomikë shtesë dhe duke marrë parasysh probabilitetet relative të secilit rezultat. Informacioni i jashtëm mund të përfshijë të dhëna ekonomike dhe parashikime të publikuara nga organet qeveritare dhe autoritetet monetare në vendet ku vepron Banka, organizata mbikombëtare si Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, dhe sektori privat i përzgjedhur dhe parashikuesit akademikë.

Rasti bazë do të paraqesë një rezultat më të mundshëm dhe do të përafrohet me informacionin e përdorur nga Banka për qëllime të tjera, siç janë planifikimi strategjik dhe buxhetimi. Skenarët tjerë do të përfaqësojnë rezultate më optimiste dhe më pesimiste. Banka gjithashtu do të kryejë në mënyrë periodike testimin e stresit të goditjeve më ekstreme për të kalibruar përcaktimin e këtyre skenarëve të tjerë përfaqësues. Banka ka identifikuar dhe dokumentuar nxitësit kryesorë të riskut të kredisë dhe humbjet e kreditit për secilin portofol të instrumenteve financiare dhe duke përdorur një analizë të të dhënave historike, ka vlerësuar marrëdhëniet ndërmjet variablave makroekonomikë dhe riskut të kredisë dhe humbjeve të kreditit. Këto drejtues kryesorë përfshijnë normat e interesit, normat e papunësisë dhe parashikimet e PBB-së. Marrëdhëniet e parashikuara midis treguesve kryesorë dhe normave të mospagimit dhe humbjeve në portofole të ndryshme të pasurive financiare janë zhvilluar bazuar në analizimin e të dhënave historike gjatë 5 viteve të fundit. Skenarët ekonomikë të përdorur do të miratohen nga Komiteti i Kreditorit të Bankës.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

4. ADAPTIMI DHE INTERPRETIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA (VAZHDIM)

4.1 Standardet dhe interpretimet e miratuara, por ende jo efektive (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentet financiare (vazhdim)

Tranzicioni

Ndryshimet në politikat kontabël që rrjedhin nga miratimi i SNRF 9 përgjithësisht do të zbatohen në mënyrë retrospektive, përveç siç përshkruhet më poshtë:

- Banka do të përfitojë nga përjashtimi duke e lejuar atë të mos rideklorojë informacionin krahasues për periudhat e mëparshme në lidhje me ndryshimet në klasifikim dhe matje (duke përfshirë provizionimin).
- Diferencat në vlerën kontabël të pasurive financiare dhe detyrimeve financiare që rrjedhin nga miratimi i SNRF 9 do të njihen në fitimet dhe rezervat e pashpërndara më 1 janar 2018.
- Përcaktimi i modelit të biznesit brenda të cilit zhvillohet një pasuri financiar do të bëhet në bazë të fakteve dhe rrethanave që ekzistojnë në datën e aplikimit fillestar.

SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët

Efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018.

Kërkesat kryesore

SNRF 15 zëvendëson të gjitha kërkesat ekzistuese të të hyrave në SNRF (SNK 11 Kontratat e Ndërtimit, SNK 18 Të Ardhurat, IFRIC 13 Programet e Besnikërisë së Klientit, IFRIC 15 Marrëveshjet për Ndërtimin e Pasurive të Paluajtshme, IFRIC 18 Transferet e Pasurive nga Konsumatorët dhe SIC 31 Të Hyrat – nga Transaksionet e Shkëmbimit që Përfshijnë Shërbimet e Reklamimit) dhe zbatohet për të gjitha të ardhurat që rrjedhin nga kontratat me klientët, me përjashtim të rasteve kur kontratat janë në objektin e standardeve të tjera, siç janë SNK 17 Qiradhënie (ose SNRF 16 Qira, një herë e aplikuar). Kërkesat gjithashtu sigurojnë një model për njohjen dhe matjen e fitimeve dhe humbjeve në dispozicion të disa pasurive jofinanciare, duke përfshirë pasuritë afatgjata materiale, ndërtesat dhe pajisjet dhe pasuritë jo-materiale. Banka po vlerëson ndikimin e mundshëm në pasqyrat financiare të saj që rezultojnë nga SNRF 15, megjithatë kjo nuk pret që të jetë material pasi që ajo nuk i ka të hyra materiale që bien nën fushëveprimin e këtij standardi.

SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 është miratuar në janar 2016 dhe zëvendëson SNK 17 Qiratë, IFRIC 4 Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një qira, SIC-15 Qiratë Operative - Nxjitjet dhe SIC-27 Vlerësimi i Substancës së Transaksioneve që përfshijnë Formën Ligjore të Qirasë. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të qirasë dhe kërkon që qiramarrësit të japin llogari për të gjitha qiratë sipas një modeli të vetëm në bilanc, ngjashëm me kontabilitetin për qiratë financiare sipas SNK 17. Standardi përfshin dy përjashtime njohjeje për qiramarrësit - dhënien me qira të pasurive "me vlerë të ulët" (p.sh., kompjuterët personalë) dhe qiratë afatshkurtra (dmth., me qira me një afat kohor me qira prej 12 muajsh ose më pak). Në datën e fillimit të një qiraje, një qiramarrës do të njohë një detyrim për të bërë pagesa të qirasë (dmth. detyrimin e qirasë) dhe një pasuri që përfaqëson të drejtën e përdorimit të pasursisë bazë gjatë afatit të qirasë (dmth. e drejta e përdorimit të pasursisë). Qiramarrësve do t'u kërkohej të njohin veçmas shpenzimet e interesit në detyrimet e qirasë dhe shpenzimet e zhvlerësimit në të drejtën e përdorimit të pasursisë.

Qiramarrësit gjithashtu do të kërkohej që të rinasin detyrimin e qirasë me rastin e ngjarjeve të caktuara (p.sh., një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë të ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks apo normë të përdorur për të përcaktuar këto pagesa). Qiramarrësi në përgjithësi do të njohë shumën e rivlerësimit të detyrimit të qirasë si një rregullim në të drejtën e përdorimit të pasursisë.

4. ADAPTIMI DHE INTERPRETIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA (VAZHDIM)

4.1 Standardet dhe interpretimet e miratuara, por ende jo efektive (vazhdim)

SNRF 16 Qiratë (vazhdim)

Kontabiliteti qiradhënësit sipas SNRF 16 është në thelb i pandryshuar nga kontabilizimi i sotëm sipas SNK 17. Qiradhënësit do të vazhdojnë të klasifikojnë të gjitha qiratë duke përdorur të njëjtin parim klasifikimi si në SNK 17 dhe të bëjnë dallimin mes dy llojeve të qirasë: qiratë operative dhe financiare.

SNRF 16 gjithashtu kërkon që qiramarrësit dhe qiradhënësit të bëjnë më shumë informacion shpjegues se sa sipas SNK 17, megjithatë Banka nuk është qiradhënëse.

SNRF 16 është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Aplikimi i hershëm lejohet, por jo përpara se një njësi ekonomike të zbatojë SNRF 15. Një qiramarrës mund të zgjedhë të zbatojë standardin duke përdorur një qasje retrospektive të plotë ose një retrospektivë të modifikuar. Provizionet e tranzicionit të standardit lejojnë lehtësime të caktuara. Një tregues i marrëveshjeve aktuale të qirasë operative jepet në Marrëveshjet e Qirasë Operative në Shënimin 25.

SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve

Në Maj 2017, BSNK publikoi SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 17), një standard i ri kontabël i përgjithshëm për kontratat e sigurimeve që mbulojnë njohjen dhe matjen, paraqitjen dhe zbulimin. Posa të hyjë në fuqi, SNRF 17 do të zëvendësojë SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve (SNRF 4) që është nxjerrë në vitin 2005. SNRF 17 zbatohet për të gjitha llojet e kontratave të sigurimit (dmth jetës, jomateriale, sigurimi i drejtpërdrejtë dhe risigurimi) llojin e subjekteve që i lëshojnë ato, si dhe garancive të caktuara dhe instrumenteve financiare me karakteristika të pjesëmarrjes së lirë. SNRF 17 është efektive për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021, me shifra krahasuese të kërkuara.

Interpretimi i IFRIC 22 Transaksionet në Valutë të Huaj dhe Konsiderata Paraprake

Transaksionet në valutë të huaj dhe Konsiderata paraprake janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018.

Interpretimi i IFRIC 23 Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat

Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.

SNRF 2 Klasifikimi dhe Matja e Transaksioneve të Pagesave të Bazuara në Aksione - Ndryshime në SNRF 2

Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, me lejen e aplikimit të hershëm.

Zbatimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve - Ndryshimet në SNRF 4

Ndryshimet adresojnë shqetësimet që dalin nga zbatimi i standardit të instrumenteve të reja financiare, SNRF 9, përpara zbatimit të SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve, i cili zëvendëson SNRF 4.

Transferet e Pronave të Investimit - Ndryshimet në SNK 40

Transferet e Pronës së Investimit janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018.

Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28: Shitja ose Kontributi i Pasurive midis një Investitori dhe Shoqatës së saj ose Sipërmarrjes së Përbashkët

Shitja ose Kontributi i Pasurive në mes të një Investitori dhe Shoqatës së tij ose Sipërmarrjes së Përbashkët dhe ndryshimet e mëtejshme datën e saj efektive shtyhet për një kohë të pacaktuar derisa të përfundohet projekti hulumtues mbi metodën e kapitalit.

4. ADAPTIMI DHE INTERPRETIMI I STANDARDEVE TË REJA OSE TË RISHIKUARA (VAZHDIM)

4.1 Standardet dhe interpretimet e miratuara, por ende jo efektive (vazhdim)

Interesat afatgjata në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta - Ndryshimet në SNK 28

Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Ky ndryshim nuk zbatohet për Bankën.

4.2 Standardet e miratuara dhe efektive për periudhën vjetore

SNK 7 Iniciativa për dhënien e informacioneve shpjeguese - Ndryshimet në SNK 7

Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017. Ndryshimet në SNK 7 Pasqyra e rrjedhës së parasë janë pjesë e Iniciativës së Publikimit të BSNK-së dhe ndihmojnë përdoruesit e pasqyrave financiare të kuptojnë më mirë ndryshimet në borxhin e një njësie ekonomike. Ndryshimet kërkojnë që njësitë ekonomike të japin informacion shpjegues rreth ndryshimeve në detyrimet e tyre që rrjedhin nga aktivitetet e financimit, duke përfshirë edhe ndryshimet që rrjedhin nga rrjedhat e parasë dhe ndryshimet jo në kesh (siç janë fitimet ose humbjet në valutë të huaj). Në aplikimin fillestar të ndryshimit, subjekteve nuk u kërkohet të japin informacion krahasues për periudhat e mëparshme. Aplikimi i hershëm është i lejuar. Ndryshimet synojnë të japin informacion për të ndihmuar investitorët të kuptojnë më mirë ndryshimet në borxhin e një njësie ekonomike. Banka ka zbatuar ndryshimin dhe ka paraqitur informacione shpjeguese shtesë rreth ndryshimeve në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet e financimit në Shënimin 22.1.

SNK 12 Njohja e Pasurive Tatimore të Shtyra për Humbjet e Perealizuara - Ndryshimet në SNK 12

Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017. Ky ndryshim nuk zbatohet për Bankën.

Deklarata e Praktikave të SNRF 2: Gjykime materialiteti

Shoqërive u lejohej të zbatojnë udhëzimet në Deklaratën e Praktikës (DP) në pasqyrat financiare të përgatitura në çdo kohë pas 14 shtatorit 2017. DP përmban udhëzime jo të detyrueshme për të ndihmuar njësitë ekonomike që të bëjnë gjykime materialiteti gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare sipas SNRF për qëllime të përgjithshme. Gjithashtu, DP mund të ndihmojë përdoruesit e pasqyrave financiare për të kuptuar se si një njësi ekonomike bën gjykime të materialitetit në përgatitjen e pasqyrave financiare. PV përmban udhëzime në tri fusha kryesore:

- Karakteristikat e përgjithshme të materialitetit.
- Një proces me katër hapa që mund të zbatohet në bërjen e gjykimeve të materialitetit gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare. Ky proces përshkruan se si një njësi ekonomike mund të vlerësojë nëse informacioni është material për qëllimet e njohjes, matjes, prezantimit dhe zbulimit.
- Si të bëhen gjykimet e materialitetit në rrethana specifike, domethënë, informacionet e mëparshme, gabimet dhe konvenantat dhe në kontekstin e raportimit të përkohshëm.

Deklarata e praktikave të SNRF 2: Gjykime materialiteti (vazhdim)

Për më tepër, DP diskuton ndërveprimin ndërmjet vendimeve të materialitetit që një entitet duhet të bëjë dhe ligjet dhe rregulloret vendore. DP përfshin shembuj që ilustrojnë se si një njësi ekonomike mund të zbatojë udhëzimet. Meqenëse DP është një dokument jo i detyrueshëm, ai nuk ndryshon ose nuk paraqet ndonjë kërkesë në SNRF. Sidoqoftë, DP siguron udhëzime të dobishme për subjektet që bëjnë gjykime të materialitetit dhe në këtë mënyrë mund të përmirësojnë efektivitetin e komunikimit të pasqyrave financiare.

Ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2014-2016)"

Duke rezultuar nga projekti i përmirësimit vjetor të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12 dhe SNK 28) kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimit (ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 .

Ndryshime në standarde të ndryshme për shkak të "Përmirësimeve të SNRF-ve (cikli 2015-2017)"

Duke rezultuar nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23), kryesisht me qëllim heqjen e mospërputhjeve dhe sqarimin e formulimit, është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.

5. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Menaxhmenti diskuton me Komitetin e Auditimit zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave kontabël kritike të Bankës dhe zbatimin e tyre si dhe supozimet e bëra në lidhje me pasiguritë e mëdha të vlerësimit. Informacioni në lidhje me supozimet dhe vlerësimet e pasigurive që kanë një risk të rëndësishëm të rezultojnë në një rregullim material brenda vitit të ardhshëm financiar dhe për gjykimet kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare të veçanta janë shpalosur më poshtë.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi menaxhimin e riskut financiar (shih shënimin 25).

a) Provizionimi

Pasuritë e llogaritura me kosto të amortizuara vlerësohen për provizionim në bazë të politikave të përshkruara të kontabilitetit në shënimin 3 (f) (vii).

Banka rishikon portofolion e saj të kredive për të vlerësuar provizionimi në baza të rregullta. Në përcaktimin nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet të regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave apo jo, Banka bënë gjykime nëse ka të dhëna që tregojnë se ka një rënie të matshme në rrjedhat e ardhshme të parasë nga portofolio e kredive para se rënia të mund të identifikohet me një kredi individuale në atë portofolio. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna që tregojnë se ka pasur një ndryshim negativ në statusin e pagesave të huamarrësve në grup, apo në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që lidhen me mungesa në pasuritë e Bankës.

Menaxhmenti përdor vlerësime të bazuara në përvojën historike të humbjeve për pasuritë me karakteristika të riskut të kredisë dhe prova objektive të provizionimit të ngjashme me ato në portofolio kur bëhet caktimi i rrjedhave të ardhshme të parasë. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e shumës dhe kohën e rrjedhave monetare të ardhshme rishikohet rregullisht për të zvogëluar ndonjë diferencë midis vlerësimeve të humbjeve dhe përvijës aktuale të humbjes.

Banka përcakton se investimet e mbajtura për shitje provizionohen kur ka një rënie të konsiderueshme ose të zgjatur në vlerën e drejtë nën koston e tyre. Ky përcaktim se çfarë është e rëndësishme ose e shtyrë, kërkon një gjykim. Në marrjen e këtij gjykimi, Banka vlerëson në mesin e faktorëve të tjerë, paqëndrueshmërinë normale në çmimin e aksionit. Përveç kësaj, zhvlerësimi mund të jetë i përshtatshëm, kur ka prova të përkeqësimit në shëndetin financiar të të investuarit, performancës së industrisë dhe të sektorit, ndryshimet në teknologji dhe rrjedhat operative dhe të financimit të rrjedhës së parave.

b) Vlera neto e realizuar e pasurive të riposeduara

Banka ka krijuar një politikë në lidhje me vlerat e drejta të pasurive të riposeduara të cilat janë duke u matur me koston më të ulët dhe vlerën neto të realizuar. Matja e vlerës së drejtë përfshin përdorimin e vlerësimeve të pavarura të jashtme të pronës, nga një vlerësues që ka kualifikimet e duhura ligjore profesionale, e cila më pas është shqyrtuar nga Menaxhmenti i Bankës për inputet e rëndësishme jo të dukshme dhe ndonjë rregullim i nevojshëm për shlyerje.

Banka nuk mban pronat e riposeduara në pasqyrën e pozicionit financiar për periudhë më të gjatë se 5 vite. Vlerat e drejta të pasurive të riposeduara të Bankës janë të kategorizuara në Nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë.

Teknikat e vlerësimit dhe inputet e rëndësishme jo të vëzhgueshme

Tabela e mëposhtme tregon teknikën e vlerësimit të përdorur në matjen e vlerës së drejtë si dhe përdorimin e inputeve të rëndësishme të pavëzhgueshme.

Teknikat e vlerësimit	Inpute të rëndësishme të pavëzhgueshme
Referencë në tregun aktual: Modeli i vlerësimit përdor çmimet dhe informacione të tjera të gjeneruara nga transaksionet e tregut duke përfshirë pasuritë identike ose të krahasueshme, detyrimet, ose një grup të pasurive dhe detyrimeve (p.sh. një biznes)	Çmimet e tregut janë modifikuar për të pasqyruar: • nivelin e transaksioneve të tregut, kur aktiviteti i tregut është i ulët ose çmimi për një pronë të njëjtë është i veshtirë për tu marrë; • gjendja specifike e secilës pronë (ndërtim, pozita etj).

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***5. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)****c) Përcaktimi i vlerës të drejtë**

Përcaktimi i vlerës së drejtë të pasurive dhe detyrimeve financiare për të cilat nuk ka çmim tregu kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit siç përshkruhet në shënimin 3. (f). (vi). Për instrumentet financiar që tregtohen rrallë dhe kanë pak transparencë të çmimeve, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon nivele të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozimeve rreth çmimit dhe risqe të tjera që ndikojnë në instrumentin specifik. Banka vlerëson vlerën e drejtë duke shfrytëzuar hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- Niveli 1: Çmim i kuotuar i tregut në tregje aktive për instrumentet identike;
- Niveli 2: Metodë vlerësimi bazuar në inpute të vlerësueshme. Kjo kategori përfshin instrumentet e vlerësuar duke shfrytëzuar: çmimet e tregut për instrumente të ngjashme në tregjet aktive; çmimet e tregut për instrumente të ngjashme në tregjet më pak aktive; apo teknika tjera të vlerësimit në të cilat të gjithë faktorët material në menyrë direkte apo indirekte janë të vëzhgueshëm nga të dhënat e tregut;
- Niveli 3: Metodë vlerësimi bazuar në inpute të rëndësishme jo të vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentët për të cilët teknikat e vlerësimit përfshijnë faktor që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe faktorët e pavëzhgueshëm kanë një ndikim material në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumentet që janë vlerësuar në bazë të çmimeve të tregut për instrumente të ngjashme për të cilat rregullime apo gjykime materiale jo të vëzhgueshme kërkohen për të reflektuar dallimet mes instrumenteve. Vlerësimi i vlerës së drejtë është shpalosur në shënimin 5 d) më poshtë.

d) Paraqitja dhe vlerësimi i vlerës së drejtë

Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në instrumente financiar në pasqyrën ekzistuese të pozicionit financiar të Bankës pa u përpjekur për të vlerësuar vlerën e biznesit të pritshëm dhe vlerën e pasurive dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumente financiar.

Instrumentët financiar - hierarkia e vlerës së drejtë

Tabela e mëposhtme tregon vlerën e drejtë të instrumentëve financiar të matura dhe jo të matura me vlerën e drejtë dhe i analizon ato sipas nivelit të tyre në hierarkinë e vlerës së drejtë, në të cilin është kategorizuar secila matje me vlerën e drejtë.

	2017			2016		
	Vlera kontabël	Vlera e drejtë Niveli 2	Vlera e drejtë Niveli 3	Vlera kontabël	Vlera e drejtë Niveli 2	Vlera e drejtë Niveli 3
Pasuritë financiare të matura me vlerën e drejtë						
Të mbajtura për shitje	17,152	17,181	-	18,267	18,299	-
Pasuritë financiare jo të matura sipas vlerës së drejtë						
Paraja e gatshme dhe në banka	51,831	-	51,831	39,939	-	39,939
Kredi dhe paradhënie për banka	1,450	-	1,450	600	-	600
Kredi dhe paradhënie për klientet	132,551	-	131,081	103,149	-	102,005
Pasuritë tjera financiare	143	-	143	237	-	237
Detyrimet financiare jo të matura sipas vlerës së drejtë						
Detyrime ndaj klienteve	177,780	-	178,415	140,598	-	141,101
Kreditë e varura	840	-	838	1,845	-	1,839
Huamarrjet	4,143	-	3,531	4,248	-	3,620
Detyrimet tjera financiare	1,673	-	1,673	1,346	-	1,346

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)

d) Paraqitja dhe vlerësimi i vlerës së drejtë

Instrumentet financiar - hierarkia e vlerës së drejtë (vazhdim)

Vlerat e drejta për pasuritë dhe detyrimet financiare të mësipërme janë përcaktuar duke përdorur nivelin 2 të të dhënave të përshkruara më lartë.

Vlerësimet e vlerave së drejtë bazohen në instrumente ekzistuese financiare në pasqyren e pozicionit financiar të Bankës pa u përpjekur për të vlerësuar vlerën e biznesit të pritshëm dhe vlerën e pasurive dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumenta financiar.

Llogaritë me bankat

Llogaritë nga bankat e tjera përfshijnë plasmanet ndërbankare. Përderisa kreditë, paradhëniet dhe depozitat janë afatshkurtëra dhe me norma të ndryshueshme, vlera e tyre e drejtë konsiderohet të jetë e barabartë me vlerën e tyre kontabël.

Bonot e thesarit

Bonot e thesarit përfshijnë bono të emetuara nga Qeveria e Kosovës, të cilat janë blerë me qëllim për t'i mbajtur deri në maturitet. Vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur një model të aktualizimit të rrjedhave të parave bazuar në një lakore aktuale të kthimit të përshtatshëm për periudhën e mbetur deri në maturim.

Obligacionet

Obligacionet janë obligacione të emetuara nga Qeveria e Kosovës, të cilat janë blerë me qëllim për tu mbajtur deri në maturitet. Çmimet e kuotuar në tregjet aktive nuk ishin të vlefshme për këto letra me vlerë. Megjithatë, ka pasur informacione të mjaftueshme të vlefshme për të matur vlerat e drejta të këtyre letrave me vlerë në bazë të inputeve të vëzhgueshme të tregut.

Kreditë dhe paradhëniet për klientët

Kur është e mundur, vlera e drejtë e kredive dhe paradhënieve është e bazuar në transaksionet e vëzhgueshme të tregut. Kur transaksionet e vëzhgueshme të tregut nuk janë në dispozicion, vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur metodat e vlerësimit, të tilla si teknikat e rrjedhave monetare të aktualizuara. Teknikat e vlerësimit përfshijnë humbjet e pritshme të kredisë, normat e interesit dhe normat e parapagimit.

Për të përmirësuar saktësinë e vlerësimit të kredive tregtare dhe të bizneseve të vogla, kreditë homogjene grupohen në portofolio me karakteristika të ngjashme.

Portofolio i kredive të Bankës ka një vlerë të drejtë të vlerësuar afërsisht si e barabartë me vlerën e tij kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër apo të normave të interesit të cilat përafrojnë me normat e tregut. Pjesa më e madhe e portofolios të kredive është subjekt i ndryshimit të çmimeve brenda një viti.

Detyrimet ndaj klientëve, huamarrjet dhe kreditë e varura

Vlera e drejtë e kredive të varura, kredive dhe detyrimeve ndaj klientëve janë vlerësuar duke përdorur teknika të aktualizimit të rrjedhës së parasë, duke zbatuar normat që janë ofruar për depozitat dhe për kredinë e varur me maturitet dhe kushte të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme sipas kërkesës është shuma e pagueshme në datën e raportimit.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***6. TË ARDHURAT NETO NGA INTERESI**

Të ardhurat neto nga interesi përbëhen si në vijim:

	2017	2016
Të ardhurat nga interesi:		
Kredi dhe paradhënie për klientët	11,203	9,716
Kredi dhe paradhënie për bankat	50	7
Investimet e vlefshme për shitje	134	98
	11,387	9,821
Shpenzimet e interesit:		
Depozitat nga klientët	(1,463)	(1,347)
Kreditë e varura	(150)	(203)
Huamarrjet	(128)	(120)
	(1,741)	(1,670)
Të ardhurat neto nga interesi	9,646	8,151

7. TË ARDHURAT NETO NGA TARIFAT DHE KOMISIONET

	2017	2016
Të ardhurat nga tarifatat dhe komisionet		
Transfere pagesash dhe transaksione	1,702	1,525
Tarifatat e mirëmbajtjes së llogarive	548	433
Tarifatat dhe komisionet tjera	59	42
Gjithsej të ardhurat nga tarifatat dhe komisionet	2,309	2,000
Tarifatat dhe komisionet nga llogaritë bankare	(557)	(422)
Tarifatat dhe komisionet nga shpërndarja e ndihmave sociale	(49)	(49)
Tarifa dhe komisione tjera	(47)	(51)
Gjithsej shpenzimet nga tarifatat dhe komisionet	(653)	(522)
Të ardhurat neto nga tarifatat dhe komisionet	1,656	1,478

8. TË ARDHURAT TJERA OPERATIVE

	2017	2016
Të ardhurat nga riposedimi i ndërtesës së Gjakovës	580	-
Fitimi nga shitja e pasurive të riposeduara	168	-
Të hyra tjera	42	35
Gjithsej	790	35

Ndërtesa e Gjakovës lidhet me një hua që është shlyer disa vite më parë. Procesi i riposedimit nuk u përfundua deri në vitin 2017 dhe ndërtesa u njoh nga të ardhurat në vitin aktual.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***9. SHPENZIMET TJERA OPERATIVE**

	2017	2016
Shpenzimet e personelit (shih më poshtë)	3,472	2,717
Shpenzimet e qirasë	641	623
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	484	398
Sigurimi dhe siguria fizike	306	290
Shërbimet komunale dhe karburanti	168	168
Riparimet dhe mirëmbajtja	160	148
Shpenzimet e komunikimit	235	137
Konsulenca	167	74
Shpenzimet ligjore	141	196
Shpenzimet e procesimit të kartelave	252	190
Shpenzimet e marketingut dhe reklamimit	251	161
Shpenzimet e pastrimit	48	42
Materialet për zyrë	58	54
Shpenzimet e anëtarëve të bordit	40	42
Shpenzimet e udhëtimit	21	15
Shpenzime tjera	441	367
Gjithsej	6,885	5,622

Numri i të punësuarve me 31 dhjetor 2017 është 340 (31 dhjetor 2016: 327).

Shpenzimet e personelit përbëhen si me poshtë:

	2017	2016
Pagat dhe medijtjet	2,741	2,323
Kontributi pensional	141	119
Bonuset e përlllogaritura	545	250
Kompensime tjera	45	25
Gjithsej	3,472	2,717

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***10. SHPENZIMET E TATIMIT NË FITIM**

Ngarkesa e tatimit në fitim ndryshon nga shuma teorike që do të krijohej duke përdorur normën mesatare të ponderuar të tatimeve të zbatueshme për fitimet e Bankës si më poshtë:

	Norma Efektive e interesit	2017	Norma Efektive e interesit	2016
Fitimi para tatimit		6,138		4,530
Tatimi i llogaritur me 10%	10%	614	10%	453
Rregullime për shkak të diferencës në provizionet e kredive bazuar në rregullat e BQK	-	-	-	-
Efekt i në tatim i kredive jashtbilancore	0.78%	48	-	-
Efekt i për shpenzimet e pazbritshme tatimore	0.70%	43	-	-
Efekt i tatimit për interesin aktual në depozita	0.15%	9	-	-
Rregullimet në të hyrat tjera	1.35%	(83)	0.44%	21
Shfrytëzimi i humbjeve tatimore të bartura përpara	-	-	(1.92%)	(87)
Tatimi në fitim	10.3%	631	8.5%	387

Tatimi i shtyrë është kalkuluar me normën prej 10%. Pasuritë nga të hyrat e shtyera tatimore janë njohur vetëm deri në masën që realizimi i përfitimit tatimor është i mundshëm. Më 31 dhjetor 2017, pasuritë nga të hyrat e shtyera tatimore, neto në shumën prej zero mijë Euro (2016: zero mijë Euro) nuk janë njohur si diferencë neto e përkohshme për shkak të pasigurisë që fitimet e tatueshme të mjaftueshme do të jenë të vlefshme për të lejuar që të shfrytëzohen në dobi të kësaj pasurie tatimore të shtyrë.

	2017	2016
Detyrimi në fillim	202	105
Shtesat gjatë vitit	631	387
Pagesat gjatë vitit	(565)	(290)
Detyrimi në fund	268	202

Periudha për bartjen e humbjeve tatimore në pajtim me Ligjin mbi Tatimin në Kosovë është gjashtë vite. Tatimi në fitim vlerësohet me normën 10% (2016:10%) nga të ardhurat e tatueshme: Tabela në vijim paraqet harmonizimin ndërmjet fitimit kontabël dhe tatimit në fitim:

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Humbjet sipas tatimeve të panjohura gjatë vitit	1,160	2,232	(87)	(789)	(1,814)	(869)	-
Humbjet tatimore të bartura përpara	1,327	3,559	3,472	2,683	869	-	-

Lëvizjet në detyrimet për tatimin e shtyrë janë prezentuar si në vijim:

	2016	Lëvizjet gjatë 2017	2017
Provizionet për kreditë e rëna në vlerë	126	(2)	124
Detyrimi për tatimin e shtyrë në fund të vitit	126	(2)	124

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***11. PARAJA E GATSHME DHE NË BANKA**

	2017	2016
Paraja e gatshme	9,981	5,743
Paraja në banka	7,852	6,948
Gjithsej	17,833	12,691

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj përbëhen si në vijim:

	2017	2016
Paraja e gatshme dhe në banka	17,833	12,691
Gjendja e pakufizuar në BQK (shënimi 12)	19,031	14,955
Gjithsej	36,864	27,646

12. GJENDJA ME BANKËN QENDRORE TË KOSOVËS

	2017	2016
Rezervat e detyrueshme	14,967	12,293
Llogaria rrjedhëse	19,031	14,955
Gjithsej	33,998	27,248

Në përputhje me kërkesat e BQK-së në lidhje me rezervën e depozitave për qëllime të likuiditetit, Banka duhet të mbajë një minimum prej 10% të depozitave të klientëve me maturitet deri në një vit, si rezerva të detyrueshme. Rezervat e detyrueshme duhet të përfaqësojnë instrumente me likuiditet të lartë, duke përfshirë para të gatshme, llogaritë në BQK, ose në bankat tjera në Kosovë, si dhe shumat e mbajtura në BQK nuk duhet të jenë më pak se gjysma e totalit të rezervave. Pasuritë me të cilat Banka mund të plotësojë kërkesat e likuiditetit janë depozitat në Euro me BQK-në dhe 50% e ekuivalentit në Euro të parave të gatshme në valuta lehtësisht të konvertueshme. Depozitat me BQK-në nuk duhet të jenë më pak se 5% e bazës së depozitave të aplikueshme.

13. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR BANKA

	2017	2016
<i>Depozita me afat</i>		
Zirat Bankasi	1,000	-
IS Bankasi	350	-
	1,350	-
<i>Llogaritë e bllokuara</i>		
Raiffeisen Bank International	100	600
	100	600
Gjithsej	1,450	600

Kreditë dhe paradhëniet në banka përfshijnë llogaritë e bllokuara në emër të garancioneve të klientëve.

14. LETRAT MË VLERË TË MBAJTURA PËR SHITJE

	2017	2016
Bono thesari	5,224	10,720
Obligacionet qeveritare	11,928	7,547
Gjithsej	17,152	18,267

Gjatë vitit 2017, Banka ka shitur rreth 19 instrumente financiare. Instrumentet financiare u shitën me çmim më të lartë në krahasim me çmimin e blerjes. Blerësi i vetëm i instrumenteve financiare ishte Banka Qendrore e Kosovës. Fitimi u njoh në pasqyrën e të ardhurave në shumë prej 1,065 mijë Euro (2016: 1,878 mijë Euro).

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***15. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTËT**

Kreditë dhe paradhëniet për klientë përbëhen si në vijim:

	2017	2016
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	136,789	107,904
Interesi akrual	658	561
Tarifat e shtyra të disbursimit	(902)	(649)
Gjithsej	136,545	107,816
Provizionet për kreditë e rëna në vlerë për klientët	(3,994)	(4,667)
Kreditë dhe paradhëniet neto të klientëve	132,551	103,149

Lëvizjet në provizionet për kreditë e rëna në vlerë janë si në vijim:

	2017	2016
Më 1 janar	4,667	4,415
Provizioni për humbjet nga kreditë	543	830
Kreditë e shlyera	(1,216)	(578)
Më 31 dhjetor	3,994	4,667

Banka menaxhon ekspozimet individuale të palëve në mënyrë që të jetë në përputhje me rregullat e Bankës Qendrore që kërkojnë ekspozimet individuale kundrejt një pale të mos tejkalojnë 15% të Kapitali Tier I.

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 nuk ka ekspozime kundrejt një pale mbi 15% të limitit. Përveç kësaj, ekspozimi kumulativ i 10 klientëve kryesor të bankës është 9,324 mijë Euro (2016: 9,757 mijë Euro).

Një barazim i lejimit për humbjet nga provizionimi për kreditë dhe paradhëniet, sipas klasës, është si më poshtë :

	2017			2016		
	Korporata	Retail	Total	Korporata	Retail	Gjithsej
Me 1 janar 2016	3,950	717	4,667	3,885	530	4,415
Ngarkesa për vitin	626	(83)	543	643	187	830
Shumat e shlyera	(897)	(319)	(1,216)	(578)	-	(578)
Me 31 dhjetor 2016	3,679	315	3,994	3,950	717	4,667

16. PASURITË TJERA FINANCIARE

	2017	2016
Shpenzimet e parapaguara	14	14
Të hyrat e shtyra nga shërbimet bankare	40	84
Tarifat dhe komisionet e shtyra	54	55
Të arkëtueshmet nga garancionet (Shënimi 23)	-	70
Kërkesa tjera	35	14
Gjithsej	143	237

17. PASURITË TJERA

	2017	2016
Shpenzime të parapaguara	815	141
Total	815	141

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***18. PASURITË E RIPOSEDUARA**

Pasuritë e riposeduara janë prona të fituara nëpërmjet zbatimit të sigurisë mbi kreditë dhe paradhëniet për klientët. Banka synon dhe po ndërmer hapa për t'i shitur ato brenda një periudhe të arsyeshme të shkurtër.

	2017	2016
Pasuritë e patundshme të banimit	558	572
Pasuritë e patundshme komerciale	1,008	1,688
Gjithsej	1,566	2,260
Minus: rënia në vlerë	(1,411)	(1,362)
Vlera neto kontabël	155	898

Vlera e drejtë e këtyre pasurive është përcaktuar duke iu referuar vlerave të tregut nga ana e vlerësuesit të jashtëm të pavarur. Vlerat janë provizionuar në varësi të vendndodhjes së tyre, mirëmbajtjes, kushteve dhe rrethanave që pasqyrojnë vonesat e mundshme në shitjen e tyre dhe gjatësinë e kohës për mbajtjen e pasurive.

Lëvizjet në zhvlerësimin e pasurive janë si në vijim:

	2017	2016
Më 1 janar	1,362	833
Provizioni për zhvlerësim gjatë vitit	197	529
Kthimet nga shitjet/heqjet	(148)	-
Më 31 dhjetor	1,411	1,362

19. PASURITË E PAPREKSHME

	Programe kompjuterike
Gjendja më 1 janar 2016	894
Shtesat gjatë vitit	156
Gjendja më 31 dhjetor 2016	1,050
Shtesat gjatë vitit	244
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,294
Amortizimi i akumuluar	-
Gjendja më 1 janar 2016	747
Shpenzimi për vitin	77
Gjendja më 31 dhjetor 2016	824
Shpenzimi për vitin	133
Gjendja më 31 dhjetor 2017	957
Vlera kontabël	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	226
Gjendja më 31 dhjetor 2017	338

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

20. PRONA DHE PAJISJET

<i>Kosto</i>	Ndërtesat	Përmirësime në objektet me qira	Mobiljet dhe orenditë	Kompjuterët dhe pajisje të ngjashme	Automjetet	Gjithsej
Më 1 janar 2016	109	774	545	1,180	597	3,205
Shtesat gjatë vitit	-	71	19	113	73	276
Shlyerjet gjatë vitit	(13)	(18)	(79)	(13)	(17)	(140)
Më 31 dhjetor 2016	96	827	485	1,280	653	3,341
Shtesat gjatë vitit	587	173	62	186	97	1,105
Shlyerjet gjatë vitit	-	(53)	(30)	(26)	-	(109)
Më 31 dhjetor 2017	683	947	517	1,440	750	4,337
Zhvlërësimi i akumuluar						
Më 1 janar 2016	15	461	441	873	374	2,164
Shpenzimi për vitin	2	90	42	95	93	321
Shlyerjet gjatë vitit	(13)	(16)	(21)	(24)	(50)	(124)
Më 31 dhjetor 2016	4	535	462	943	417	2,361
Shpenzimi për vitin	3	119	51	122	56	351
Shlyerjet gjatë vitit	-	(46)	(29)	(25)	-	(100)
Më 31 dhjetor 2017	7	608	484	1,040	473	2,612
Vlera kontabël						
Më 31 dhjetor 2016	92	292	23	337	236	980
Më 31 dhjetor 2017	676	339	33	400	277	1,725

Më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 Banka nuk ka ndonjë pronë të deklaruar si peng.

Në kuadër të pronave dhe pajisjeve me 31 dhjetor 2017 ka ndërtesa me vlerë 676 mijë Euro (2016: 92 mijë Euro) të riposduara si kolateral dhe që menaxhmenti i shfrytëzon për aktivitetet e përditshme të Bankës.

Në vijim janë disa zëra të pasurive dhe pajisjeve të cilat janë zhvlërësuar plotësisht por që janë ende në shfrytëzim më 31 dhjetor 2017:

Kategoria	Kosto	Zhvlërësimi i akumuluar	Vlera Neto
Ndërtesa	9	9	-
Përmirësimet në objekte me qira	418	418	-
Mobilje dhe orendi	511	511	-
Kompjuterë dhe pajisje të ngjashme	674	674	-
Vetura	237	237	-
Softuerë	771	771	-
Gjithsej	2,620	2,620	-

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***21. DEPOZITAT NGA KLIENTËT**

	2017	2016
Llogaritë rrjedhëse	70,685	60,214
Në Euro	67,132	58,565
Në valuta të huaja	3,553	1,649
Depozitat e afatizuara	107,095	80,384
Në Euro	106,368	78,388
Në valuta të huaja	727	1,996
Gjithsej	177,780	140,598

22. KREDITË E VARURA DHE HUAMARRJET

	2017	2016
Kreditë e varura		
BERZH	-	1,005
<i>Individët:</i>		
Valon Budima	420	420
Armend Skeja	420	420
Gjithsej	840	1,845

Gjatë vitit 2017, Banka ka parapaguar plotësisht borxhin e varur në BERZH në vlerë prej 1,000 mijë Euro së bashku me interesin në shumën prej 25 mijë Euro dhe pagesën e provizionit të parapagimeve prej 20 mijë Euro. Parapagimi është kryer pas miratimit nga BQK-ja.

Kreditë e varura janë dhënë nga palët e mësipërme për ti lejuar Bankës të mbajë nivelet minimale të kapitalit rregullator.

Kreditë e varura nga individët është i ripagushme më 26 dhjetor 2023. Ky borxh i varur nuk ka kushte të veçanta të bashkangjitura me marrëveshje.

Huamarrjet	2017	2016
Huamarrja nga FEEJ	3,128	3,240
Huamarrja nga BERZH	1,015	1,008
Gjithsej	4,143	4,248

Gjatë vitit 2016, Banka ka hyrë në një marrëveshje huamarrëse me BERZH (Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim) për një total prej 1,000 mijë Euro. Qëllimi është për të mbështetur individët privat dhe portofolion e kredive të NVM-ve në lidhje me programin e efikasitetit të energjisë. Huamarrja bartë një normë interesi vjetor prej 3.6%, dhe është e pagueshme brenda pesë viteve. Interesi është i pagueshëm në baza tremujore.

Gjatë vitit 2015, Banka ka hyrë në një marrëveshje huamarrëse me FEEJ (Fondi Evropian për Evropën Juglindore) për një total prej 1,000 mijë Euro. Qëllimi është për të mbështetur individët privat dhe portofolion e kredive të NVM-ve. Huamarrja bartë një normë interesi vjetor prej 3.4%, dhe është e pagueshme brenda tri viteve. Interesi është i pagueshëm në baza tremujore.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***22. KREDITË E VARURA DHE HUAMARRJET (VAZHDIM)****22.1 Ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet e financimit paraqiten si më poshtë:**

	1 janar 2017	Hyrjet e parasë	Daljet e parasë	Interesi akrual	Dividenda e deklaruar	31 dhjetor 2017
Kreditë e varura	1,845	-	(1,005)	-	-	840
Huamarrjet	4,248	1,500	(1,595)	(10)	-	4,143
Dividendat e pagueshme	-	-	(285)	-	285	-
Gjithsej detyrimet nga aktivitetet financuese	6,093	1,500	(2,885)	(10)	285	4,983

23. DETYRIME TJERA DHE PROVIZIONE

	2017	2016
Pagesat në tranzit	712	593
Provizionet për letër garancionet e lëshuara nga Banka	19	-
Të pagueshme në emër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale	630	450
Të pagueshme në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave	121	78
Detyrime ndaj furnitorëve	191	225
Gjithsej detyrime tjera	1,673	1,346
Provizione tjera (shiko shënimin më poshtë)	506	404
Gjithsej	2,179	1,750

Banka vepron si agent për transaksionet e kryera në emër të institucioneve qeveritare me palët e treta. Kjo përfshin pagesat në emër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Provizionet e tjera përfaqësojnë një provizion të krijuar për çështje ligjore kundrejt palëve të treta. Bazuar në politikat dhe procedurat e bankës, banka përcakton në secilin tremujor rezervat aktuale përmes rivlerësimit të secilës çështje ligjore individualisht.

Në vijim është paraqitur lëvizja në provizione më 31 dhjetor:

	2017	2016
Në fillim të vitit	404	642
Shtesat gjatë vitit	123	622
Të shfrytëzuara gjatë vitit	(21)	(860)
Në fund të vitit	506	404

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***24. KAPITALI AKSIONAR DHE REZERVAT*****Kapitali aksionar***

Në pajtim me Ligjin nr. 04/L-093 për “Banka, Institucione Microfinanciare dhe Institucione Financiare Jo-Bankare”, kapitali aksionar minimal për bankat që operojnë në Kosovë duhet të jetë 7 milion Euro.

Me 31 dhjetor 2017 kapitali aksionar i autorizuar ishte i përbërë nga 28,530 aksione të zakonshme (2016: 28,530 aksione të zakonshme). Aksionet e zakonshme kanë një vlerë nominale prej 394.2 Euro secili (2016: 394.2 Euro). Pronarët e aksioneve të zakonshme kanë të drejtë të marrin dividendë që deklarohet kohë pas kohe dhe kanë të drejtën e një vote për aksion në mbledhjet e Bankës. Të gjitha aksionet renditen në mënyrë të barabartë në lidhje me pasuritë e mbetura të Bankës.

Një përmbledhje e strukturës së pronësisë është si vijon:

	<i>Emri i aksionarit</i>	2017		2016	
		%	EUR ('000)	%	EUR ('000)
1	Afrim Govori	21.27	2,392	21.27	2,392
2	Rrustem Aliaj	17.27	1,942	17.27	1,942
3	Shaqir Palushi	11.81	1,328	9.91	1,115
4	BERZH	10.00	1,125	10.00	1,125
5	Mejdi Rexhepi	9.35	1,052	9.35	1,052
6	Moneta SH.P.K	7.15	804	5.35	601
7	Nazmi Viça	6.89	775	6.89	775
8	Kareman Limani	4.85	545	4.85	545
9	Banka di Cividale	4.62	520	4.62	520
10	Ahmet Arifi	2.39	269	2.39	269
11	Ismet Sylejmani	1.90	214	1.90	214
12	Naser Aliu	0.50	57	0.62	70
13	Besnik Vrella	0.50	57	0.62	70
14	Agim Bilalli	0.50	57	0.62	70
15	Luani Limited	0.44	49	0.44	49
16	Sokol Krasniqi	0.38	42	0.38	42
17	Flamur Bryma	0.09	10	0.09	10
18	Naim Abazi	0.09	9	0.44	50
19	Rasim Gashi	-	-	1.54	173
20	Riza Mikullovc	-	-	1.45	163
	Gjithsej	100.00	11,247	100.00	11,247

Rezerva tjera

Rezerva tjera të kapitalit janë krijuar që nga 31 dhjetori 2011 si diferencë mes humbjes së akumuluar në përputhje me SNRF dhe BQK të cilat janë fshirë me anë të një reduktimi në kapitalin aksionar. Si rezultat i kësaj, këto rezerva janë të kufizuara dhe nuk mund të shpërndahen.

Rezerva për rivlerësim

Gjatë vitit 2014, Banka ka vendosur të përfshijë në kategorinë e pronës dhe pajisjeve një ndërtesë e cila ka qenë me parë pasuri e riposeduar. Ndërtesa u njoh nga Banka në prona dhe pajisje me shumën korresponduese në rezervën e rivlerësimit në kapital.

Banka për Biznes Sh.a.**Shënime për Pasqyrat Financiare**

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

*(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)***25. ZOTIMET DHE KONTIGJENTET**

Banka lëshon garancion për klientët e saj. Këto instrumente bartin një risk kreditimi të ngjashëm me ato të kredive të dhëna. Garancionet e lëshuara në favor të klientave janë siguruar me kolateral në para dhe kolateral jo në para (pasuri të paluajtshme dhe kolateral të luajtshëm).

Garancionet e lëshuara të klientëve	2017	2016
Të siguruar me depozita kesh	591	828
Të siguruar me kolateral (patundshmëri dhe kolateral i luajtshëm)	713	604
Të pasiguruara	-	794
Minus: Provizionet e njohura si detyrime	(29)	(58)
Gjithsej	1,275	2,168

Zotimet përfaqësojnë balancat e patërhequra të kredive, mbitërheqjeve dhe limitet e kredit kartelave të lëshuara të klientët.

Zotimet për kredi	2017	2016
Kreditë e aprovuara por të padisbursuara	51	420
Limitet e pashfrytëzuara të mbitërheqjeve	5,395	4,779
Kredit kartelat e pashfrytëzuara	453	416
Gjithsej	5,899	5,615

Ligjore

Banka përfshihet në procedurë të zakonshme ligjore në rrjedhën normale të biznesit më 31 dhjetor 2017 dhe 2016. Menaxhmenti i Bankës është i mendimit se nuk do të lindin humbje materiale në lidhje me kërkesat ligjore, përveç atyre të parashikuara dhe të njohura në fitim ose humbje siç shpalosen në Shënimin 23.

Zotimet e qirasë

Banka ka zotime për qira të cilat janë të detyrueshme e që përbëhen si në vijim:

	2017	2016
Jo më vonë se 1 vit	138	510
Me shume se një vit dhe jo më shumë se 5 vite	504	113
Gjithsej	642	623

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR

a) Hyrje dhe përmbledhje

Banka është e ekspozuar në risqet e mëposhtme nga përdorimi i pasurive financiare:

- risku i tregut;
- risku i kreditimit;
- risku i likuiditetit.

Ky shënim prezanton informacion për ekspozimin e bankës ndaj secilit nga risqet e përmendura më lart, objektivin e Bankës, politikat dhe procedurat për matjen dhe menaxhimin e riskut dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

Korniza për menaxhimin e riskut

Bordi i drejtorëve ("Bordi") ka përgjegjësi për themelimin dhe mbikqyrjen e kuadrit për menaxhimin e riskut të Bankës. Bordi ka themeluar Komitetin e Auditimit dhe Komiteti i Riskut, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të Bankës mbi menaxhimin e riskut në fushat e tyre specifike. Politikat e Bankës për menaxhimin e riskut janë themeluar për të identifikuar dhe analizuar risqet me të cilat ballafaqohet Banka, për të vendosur kufizimet e duhura të riskut dhe kontrollit si dhe të monitorojnë riskun dhe respektojnë limitet. Politikat dhe sistemet për menaxhimin e riskut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara.

Banka përmes trajnimeve, procedurave dhe politikave për menaxhim, synon të zhvillojë një ambient kontrollues konstruktiv, në të cilin të gjithë punonjësit i kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit të Bankës është përgjegjës për monitorimin e pajtueshmërisë me politikat dhe procedurat për menaxhimin e riskut të Bankës dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e kornizës për menaxhimin e riskut në raport me risqet me të cilat përballet Banka. Komiteti i Auditimit të Bankës në këto funksione ndihmohet nga Departamenti për Auditimin e Brendshëm. Auditimi i Brendshëm kryen rishikimet e rregullta dhe ad-hoc të kontrollit dhe procedurave për menaxhim të riskut, rezultati i të cilave raportohet tek Komiteti i Auditimit.

Banka operon në kushtet e një krize globale financiare dhe ekonomike dinamike në zhvillim e sipër. Zgjerimi i saj mund të rezultojë në implikime negative në pozicionin financiar të Bankës. Menaxhmenti i Bankës monitoron çdo ditë pozicionin e pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve si edhe të zhvillimit të tregjeve financiare ndërkombëtare. Bazuar në këtë, menaxhmenti analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe implementon masa të përshtatshme në lidhje me kredi, tregun (kryesisht normën e interesit) dhe riskut të likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet e mundshme negative nga kriza globale financiare dhe ekonomike. Në këtë mënyrë Banka i përgjigjet sfidave të tregut duke mbajtur një kapital të mjaftueshëm dhe një pozicion likuiditeti.

b) Risku kreditor

Risku kreditor është risku i humbjeve financiare për Bankën nëse një klient apo një palë tjetër e lidhur për një instrument financiar dështon të përmbushë detyrimet kontraktuale, që vijnë nga kreditë dhe paradhëniet e Bankës për klientët dhe për bankat e tjera. Me qëllim të raportimit të menaxhimit të riskut, Banka merr parasysh dhe konsolidon të gjitha elementet e ekspozimit ndaj riskut kreditor (të tilla si risku standard i huamarrësit individual, risku shtetëror dhe sektorial).

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

b) Risku kreditor (vazhdim)

Menaxhimi i riskut kreditor

Bordi i Drejtorëve e ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e riskut kreditor te Komiteti i Riskut që aprovon të gjitha ekspozimet kreditore për këto kategori: kredi biznesi SME dhe kredi personale PI deri në 50 mijë Euro, të cilat duhet të aprovohen nga Departamenti i Riskut.

Ekspozimet kreditore më të mëdha se 50 mijë Euro dhe më pak se 10% e kapitalit të klasit të parë të Bankës aprovohen nga Departamenti i Riskut / Komiteti i Kredive, ndërsa ekspozimet mbi 10% të kapitalit të bankës duhet të aprovohen nga Bordi i Drejtorëve.

Bazuar në kërkesën e autoritetit rregullator, gjatë vitit 2017, Banka ka bërë ndryshime në përgjegjësitë e menaxhimit të riskut dhe veçanërisht në menaxhimin e riskut kreditor. Që nga Marsi i vitit 2017, sipas Rregullores mbi Qeverisjen Korporative të Bankave, është prezantuar struktura e re organizative ku Departamenti i Riskut është ndarë në dy departamente të veçanta, Departamentin e Menaxhimit të Riskut dhe Departamentin e Riskut Kreditor.

Departamenti i Menaxhimit të Riskut është përgjegjës për përpilimin apo rishikimin e politikave dhe procedurave që lidhen me riskun kreditor dhe njëkohësisht është përgjegjës për procesin e vlerësimit të pronave të paluajtshme, procesin e monitorimeve të kredive, klasifikimin e kredive dhe peshimin e mjeteve të riskut sipas Rregullores së Adekuatshmërisë së Kapitalit si dhe identifikimin e riskut kreditor që rrjedhë nga produktet/proceset e reja që involvojnë kreditimin. Departamenti i Menaxhimit të Riskut është i organizuar në tre sektorë duke përfshirë Sektorin e Riskut Kreditor, Sektorin e Riskut të Tregut dhe Likuiditetit, si dhe Sektorin e Riskut Operacional.

Departamenti i Riskut Kreditor është përgjegjës për menaxhimin e procesit të vlerësimit të aftësisë kredimarrëse dhe kapacitetit kreditor, vlerësimin e mjaftueshmërisë së kolateralit, procesin e vendimarrjes, monitorimin/menaxhimin e kredive problematike dhe jo-performuese, duke i përfshirë edhe kreditë në humbje dhe ato të shlyera që menaxhohen nga kompanitë e jashtme (outsourcing), si dhe identifikimin e riskut kreditor që rrjedhë nga produktet/proceset e reja që involvojnë kreditimin. Departamenti i Riskut Kreditor përfshin sektorin e huadhënies dhe sektorin e menaxhimit të vonesave (collection).

Banka ka ndjekur strategjinë e përcaktuar lidhur me diversifikimin e mëtejshëm të kredive dhe rritjen e portfolios kreditore sipas segmenteve të percaktuara të kredive, më saktësisht në segmentet e kredive individuale – PI, segmentin e kredive MIKRO dhe AGRO dhe segmentin e kredive SME. Gjatë vitit 2017 Banka ka bërë një rritje të konsiderueshme të portfolios kreditore edhe sipas volumit edhe sipas numrit, dhe rritja kryesisht ka ardhur nga segmentet e synuara të kredive, respektivisht në segmentet e kredive PI, MIKRO dhe AGRO. Për të mbështetur këtë strategji të rritjes në kredi të vogla, banka është dashur të rris numrin e stafit posaqërisht në nivel të degës, me ç'rast ka bërë rekrutimin e shumë analistëve të kredive me përvojë kryesisht nga bankat më të mëdha që operojnë në vend.

Segmenti i portfolios së kredive bazohet në llojin dhe madhësinë e subjektit (huamarrësit), dhe në përgjithësi grupohet në klientët Retail dhe Biznes.

Klientët Retail ose Individual Privat (PI) dhe në këtë grup futen të gjitha llojet e klientëve që kanë burim kryesor të hyrat nga pagat, qiratë stabile, pensione, honorare dhe të hyra tjera të verifikueshme.

Klientët e biznesit ndahen në tre segmente kryesore; MICRO, SME dhe Korporata. Ekziston edhe një nënkategori e klientëve të agrobiznesit të grupuar si klientë AGRO, të cilët shpërndahen sipas procedurave të ndarjes ndërmjet sektorëve kryesorë në MICRO AGRO dhe SME AGRO.

Klientët e biznesit konsiderohen të gjithë klientët të cilët kanë burimin kryesor të të ardhurave nga veprimtaria e biznesit. Segregimi ndërmjet segmenteve të biznesit bazohet në qarkullimin vjetor. Të gjithë klientët e biznesit që kanë qarkullim vjetor deri në 300 mijë Euro konsiderohen si klientë MIKRO. Të gjithë klientët e biznesit që kanë qarkullim vjetor prej 301 mijë deri në 2 milion Euro konsiderohen klientë të SME, ndërsa të gjithë klientët e biznesit që kanë qarkullim vjetor mbi 2 milion Euro konsiderohen si klientë Korporatë.

Banka për Biznes Sh.a.

Shënime për Pasqyrat Financiare

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Shumat janë në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

26. MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

b) Risku kreditor (vazhdim)

Menaxhimi i riskut kreditor (vazhdim)

Lidhur me kërkesat rregullative për raportimin sipas IFRS 9, banka ka filluar projektin e implementimit dhe është në proces. Gjatë vitit 2017, banka ka rekrutuar konsulent për të asistuar në krijimin e metodologjisë dhe implementimin e softuerit. Banka është në proces të zhvillimit të modelit dhe drafti i parë me metodologji pritet të finalizohet në kuartalin e parë të vitit 2018.

Në funksion të strategjisë së bankës për rritjen e portfolios dhe biznesit të saj në segmentet Mikro dhe NVM, banka ka lidhur marrëveshje me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore, për sigurimin e pjesëshëm të kredive ndaj klientëve NMVM (Ndërmarrje Mikro, të Vogla dhe të Mesme) që i disburson BPB. Ky fond apo kjo garanci kreditore jepet për të lehtësuar rritjen e kredidhënies nga banka per NMVM ne Kosovë, duke përmirësuar kushtet dhe duke rritur volumin e kredive për NMVM-te.

Në muajin Gusht 2016 banka ka lidhur marrëveshjen e parë në vlerë prej 1.5 milion Euro me FKGK. Duke marrë përbazë rritjen e vazhdueshme ky fond është përmbushur në plotësi dhe në Qershor 2017 është lidhur marrëveshje e re për 1.5 milion Euro garanci shtesë nga ky fond, duke arritur vlerën e garantuar nga fondi në 3 milion Euro.

Gjatë vitit 2017, banka ka vazhduar relacionet me Institucione Financiare Ndërkombëtare (BERZH, FEEJ, IFC dhe Blue Orchard), ku ka marrë edhe një linjë kreditore nga FEEJ në shumë prej 1.5 milion Euro. Gjatë vitit 2017, banka ka realizuar edhe një Asistence Teknike nga FEEJ e cila ka qenë e destinuar kryesisht për Departamentin e Menaxhimit të Riskut. Përmes kësaj asistence, është bërë rishikimi i të gjitha dokumenteve ekzistuese, janë krijuar disa dokumente të reja për disa fusha të riskut, janë rishikuar dhe avancuar proceset ekzistuese dhe të reja, si dhe janë organizuar trajnime të ndryshme për stafin e riskut dhe biznesit lidhur me procesin e kredidhënies, analizave financiare dhe menaxhimin e vonesave.

Banka ka përmirësuar procesin e kreditimit duke zhvilluar një softuer për menaxhimin e aplikacioneve të kredive. Zhvillimi është ndarë në tri faza me qëllim që të mbulojë tërë jetëgjatësinë e kredive nga aplikimi deri në likuidim. Faza ose moduli i parë është zhvilluar dhe gjatë vitit 2017 është funksionalizuar plotësisht. Ky modul ka mundësuar automatizimin dhe digjitalizimin e procesit të huadhënies, i cili ka rritur shpejtësinë e aprovimit dhe në të njëjtën kohë ka rritur cilësinë, sasinë, disponueshmërinë dhe qasjen në informata për klientët. Ky zhvillim ka mundësuar gjithashtu analiza të avansuara shumë-nivelëshe dhe kontroll të plotë të procesit të huadhënies deri në detajin e fundit.

Gjatë vitit 2017, ka filluar edhe faza e dytë e zhvillimit të aplikacionit që ka për objektiv të mbulojë procesin e Monitorimit. Ideja e konceptit është prezantuar dhe ka filluar zhvillimi i aplikacionit. Ky modul mbulon monitorimin e ekspozimeve financiare dhe shërben si një sistem i paralajmërimit të hershëm jo vetëm për të menaxhuar dhe mbajtur klientët e kredituar, por edhe për të parandaluar dhe parashikuar përkeqësimin e kushteve financiare të klientëve.

Në muajt në vijim, do të vazhdoj faza e tretë e zhvillimit që ka për objektiv të mbuloj menaxhimin e vonesave dhe arkëtimit të borxheve. Ky modul do të zhvillohet për të mbështetur procesin e menaxhimit dhe arkëtimit të borxheve duke siguruar menaxhim të strukturuar të të dhënave, korrespondencave, alarmeve dhe njoftimeve.

Duke zhvilluar këto tre module kryesore, të gjitha të dhënat në lidhje me huanë dhe klientët e kredisë do të jenë në dispozicion në një vend, të strukturuar dhe të ndërlidhura. Kjo do të mundësojë një qasje holistike në menaxhimin, monitorimin dhe kontrollin e riskut kreditor.

Krahas rritjes së portfolios kreditore dhe zvogëlimit të ekspozimeve të mëdha, Banka ka vazhduar edhe me përmirësimin e mëtejshëm të kualitetit të kredive, duke qenë në linjë edhe me trendin e përmirësimit të kualitetit të kredive në nivel të industrisë bankare. Sa i përket indikatorit të kualitetit të kredive – Kreditë jo-performuese (KJP), derisa në vitin 2016 ka qenë 4.94 %, në vitin 2017 ky indikator është përmirësuar në 2.97 % dhe ka qenë më mirë se sa mesatarja e industrisë bankare prej 3.10 %. Përmirësime ka pasur poashtu edhe tek kategoritë tjera të kredive, kreditë me probleme (C, D, E) dhe kreditë me vonesa (B, C, D, E).

Banka për Biznes Sh.a.

